



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 40/2020 regjistër (JR)
Datë 21.09.2020

Nr. 29 i vendimit
Datë 21.07.2022

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Natasha Mulaj	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 21.07.2022, ditën e enjte, në orën 09:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonči Petković, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 40/2020, datë 21.09.2020, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 256, datë 12.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Deda.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni C, pika 2 e neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e Komisionerit Publik të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 256, datë 12.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, shqyrtoi parashtrimet e subjektit të rivlerësimit dhe të avokatit të tij, z. Julian Mërtiri, të cilët kërkuan përfundimisht lënien në fuqi të vendimit nr. 256, datë 12.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, me detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) administroi raportet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).
3. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të deklaratës së pasurisë¹, duke konstatuar se: *i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin; ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin² për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në të cilin ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Deda.*
5. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), në cilësinë e organit ndihmës për vlerësimin profesional që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar, bazuar në ligjin nr. 84/2016 dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”), ka përcjellë pranë Komisionit raportin³ për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga organet ndihmëse siç janë pasqyruar më sipër, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit – vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale – duke marrë vendimin nr. 256, datë 12.06.2020.

¹ “Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Etleva Deda” është përcjellë në Komision nga ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 06.07.2018.

² Raporti nr. {***} prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KZHD-së nr. {***}, datë 24.01.2019, përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 29.01.2019.

³ “Raporti për analizimin e aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit Etleva Deda” i KLGj-së, me nr. {***} prot., datë 18.07.2019.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 256, datë 12.06.2020, vendosi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Deda, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a” dhe 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, mbështetur në konkluzionet e arritura për secilin prej kritereve të rivlerësimit, si më poshtë.

7.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, [...] bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit, nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht dhe ka pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezulton të jetë e ligjshme dhe nuk ka deklarim të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit. [...] subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

7.2 Për kriterin e kontrollit të figurës, [...] subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Gjithashtu, nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë [...] subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

7.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, [...] subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe konsiderohet “i aftë”. [...] subjekti i rivlerësimit ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

8. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, konfirmohet në detyrë, pasi ka plotësuar së bashku kushtet:
- ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
 - ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
 - ka arritur nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

III. Shkaqet e ankimit

9. Komisioneri Publik Florian Ballhysa ka paraqitur ankim⁴ kundër vendimit nr. 256, datë 12.06.2020, të Komisionit i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, znj. Etleva Deda.
10. Komisioneri Publik, në ankim, ka parashtruar se nga shqyrtimi i vendimit nr. 256, datë 12.06.2020, të Komisionit, çmon se ai është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’iu paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, ankimi i Komisionerit Publik evidenton si çështje për gjykim rezultatet e hetimit administrativ, për të cilat subjektit të rivlerësimit i është kaluar barra e provës dhe për të cilat nuk ka arritur të provojë të kundërtën.

⁴ Ankimi i Komisionerit Publik, publikuar në: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2020/08/38.Ankim-kund%C3%ABr-vendimit-nr.-256-dat%C3%AB-12.6.2020-t%C3%AB-KPK-s%C3%AB-p%C3%AB-sr-znj.-Etleva-Deda.pdf>.

Në referencë të përmbajtjes të nenit 4, pika 2, nenit 59, pika 1 dhe nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik çmon se gjykimi i rrethanave ligjore dhe i fakteve të mësipërme nga ana e Kolegjit, është i nevojshëm, me qëllim për të arritur në një vendimmarrje të Kolegjit, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit.

11. Komisioneri Publik ka evidentuar shkaqe lidhur me nevojën për kontrollin e vendimit të Komisionit nga Kolegji për kriterin e vlerësimit të pasurisë, për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 115 m² në Tiranë, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë parashtruar si vijon.

- i.* Deklarime të pasakta/të pamjaftueshme lidhur me posedimin e likuiditeteve *cash* ndër vite nga ana e subjektit të rivlerësimit, që kanë shërbyer si burim për blerjen e pasurisë.
- ii.* Pamjaftueshmëri të të ardhurave të ligjshme për të mbuluar kursimet dhe shpenzimet e deklaruara.
- iii.* Burimi i ligjshëm i dhuruesit, z. B. D., për të dhuruar shumën 15.000 euro.
- iv.* Pamjaftueshmëri financiare të subjektit të rivlerësimit për blerjen e pasurisë.
- v.* Cenimi i besimit të publikut të sistemi i drejtësisë për shkak të krijimit të të ardhurave shtesë, duke përdorur shumën e përfituar si kredi me kushte lehtësuese.

12. Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë.

Komisioneri Publik, bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, si dhe neneve 4 e 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, ka kërkuar që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji të vendosë:

- o Ndryshimin e vendimit nr. 256, datë 12.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Deda.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

13. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin nga Komisioneri Publik të një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

14. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016

dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

15. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 256, datë 12.06.2020, për subjektin e rivlerësimit, znj. Etleva Deda (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike, e zhvilluar në prani të palëve.
- Në vijim të kërkesës së subjektit të rivlerësimit, drejtuar trupit gjykues, për marrjen në cilësinë e provës të akteve shkresore të depozituara së bashku me parashtrimet e tij, trupi gjykues, pasi dëgjoi edhe Komisionerin Publik lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, me vendim të ndërmjetëm⁵, në bazë të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të administrojë në cilësinë e provës, aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit⁶.
16. Gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, u administrua denoncimi i z. S. T., i regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 18.05.2020 dhe nr. {***} prot., datë 18.05.2020, i cili iu vu në dispozicion paraprakisht subjektit të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik. Subjekti i rivlerësimit paraqiti parashtrime, si dhe aktet shkresore në mbështetje të tyre, të administruara nga Kolegji në cilësinë e provës, duke argumentuar mbi faktet e denoncuar.
- Komisioneri Publik, pas parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit mbi denoncimin në fjalë, gjatë seancës gjyqësore, u shpreh se denoncimi nuk ndikon në shkaqet e ankimit, për pasojë hetimin e mëtejshëm mbi të e lë në vlerësimin e trupit gjykues.
- Trupi gjykues, pasi dëgjoi qëndrimet e palëve në gjykim, arriti në përfundimin se në përmbajtjen e denoncimit të përcjellë në Kolegj, nuk u gjenden fakte dhe rrethana të vlefshme për të hetuar më tej, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

17. Shkaqet e ankimit të parashtruara prej Komisionerit Publik në ankim, kundërshtojnë konkluzionet e arritura nga Komisioni për kriterin e kontrollit të pasurisë. Konkretisht, ato lidhen me përfundimet e arritura mbi burimet e krijimit të pasurisë së paluajtshme “apartament me sipërfaqe 115 m² në rrugën “{***}”, Tiranë” (në vijim “apartamenti”), pasurisë së vetme të subjektit të rivlerësimit, për të cilën ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, si vijon:

⁵ Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 05.07.2022.

⁶ i. Vërtetim, nr. {***} kërkesë, datë 07.06.2022, i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore e ASHK Durrës; ii. certifikatë çregjistrimi, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, më datë 08.04.2020; iii. vendim nr. {***}, datë 12.02.2020, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; iv. shkresë nr. {***} prot., datë 12.11.2021, e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, e cila ka bashkëlidhur vendimin e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar “Për shpalljen e moskompetencës lëndore”, datë 09.11.2021.

Më datë 09.10.2009, kam lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK kontratën e porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., ku, me cilësinë e porositëses, kam porositur një apartament banimi me sipërfaqe 115 m², në kat të pestë banimi, seksioni {***}, në rrugën “{***}”, Tiranë. Shuma totale e apartamentit është 800 euro/m² dhe në total shuma e përgjithshme është 92.000 euro, nga të cilat 72.000 euro i kam likuiduar atë ditë dhe 20.000 euro do t'i likuidoja me kryerjen e aktit përfundimtar të shitblerjes.

Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.11.2011, unë dhe administratori i shoqërisë “{***}” ShPK kemi deklaruar se atë ditë kam shlyer shumën e përgjithshme prej 92.000 eurosh. Sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.12.2011, nga shoqëria “{***}” ShPK (me cilësinë e shitësit) kam blerë një apartament banimi nr. {***}, me sipërfaqe 107,5 m², në shkallën nr. {***}, kati i pestë, ap. {***}, në rrugën “{***}”, Tiranë, në zonën kadastrale {***}, si dhe 8,16 m² sipërfaqe ambientesh të përbashkëta, në vlerën 92.000 euro. Këtë pasuri e kam regjistruar në ZRPP Tiranë, pasqyruar në certifikatën për vërtetim pronësie nr. {***}, datë 13.12.2011.

Burim i të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie janë:

Më datë 18.09.2006, kam lidhur me Raiffeisen Bank ShA kontratën e kredisë bankare për blerje apartamenti me nr. {***} rep., nr. {***} kol.. Shuma totale e kredisë është 5.000.000 lekë.

Të ardhura nga paga të siguruara nga puna ndër vite të përshkruara më poshtë.

Sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.04.2011, prindërit e mi B. e I. D. në muajin tetor të vitit 2009, më kanë dhuruar shumën prej 15.000 eurosh.

Në kuadër të privatizimit të banesave shtetërore, më datë 11.04.1994, unë me prindërit e mi B. e I. D. dhe motrën madhore A. D. (A.), kemi privatizuar apartamentin 2+1 ku banonim, të ndodhur në: Lagjja nr. {***}, rruga “{***}”, pallati nr. {***}, kati {***}, me sipërfaqe 77,35 m². Më 25.03.2004, këtë apartament banimi e kemi shkëmbyer me apartamentin 2+1 të ndodhur në katin e parë të po këtij pallati, me sipërfaqe 73,85 m², pasqyruar në kontratën e shkëmbimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.03.2004. Sipas vërtetimit hipotekor nr. {***}, datë 05.04.2004, apartamenti nr. {***}, me sipërfaqe 73,85 m², shkalla e parë, kati i parë, kalon në pronësi të familjes D.. Ky apartament, me vendimin nr. {***}, datë 18.10.2007, është kthyer nga apartament banimi në ambient shërbimi me sipërfaqe 47,7 m² dhe 26,15 m².

Sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.12.2007, ambientin e shërbimit (dyqani) me sipërfaqe 26,15 m², në katër bashkëpronarët ia kemi shitur shtetasit F. Ç., në vlerën 1 milion lekë, ku unë përfitova pjesën takuese prej 250.000 lekësh.

Sipas kontratës së shitblerjes me rezervë me afat nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.07.2013 dhe deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.08.2013, ambientin e shërbimit (dyqan) me sipërfaqe 47,7 m², në katër bashkëpronarët ua kemi shitur shtetasve A. e E. Ç., në vlerën 55.000 euro, ku unë përfitova pjesën takuese prej 13.750 eurosh.

Gjithashtu, për blerjen e apartamentit në pronësinë time, babai im B. D. më ka dhuruar shumën prej 4.000 eurosh. Ky fakt provohet me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.11.2011.

Për të shlyer vlerën e plotë për blerjen e e apartamentit, i kam marrë hua shtetasve H. D. (vjehera e xhaxhait tim B. D.) shumën prej 8.000 eurosh, veprim të cilin e kemi dokumentuar në kontratë huaje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.11.2011. Këtë hua ia kam shlyer, referuar deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.08.2013.

18. Në përfundim të verifikimit e kontrollit të kësaj pasurie, Komisioni, në vendim, ka arritur në konkluzionin⁷: Komisioni kreu analizën financiare për subjektin e rivlerësimit, lidhur me burimin

⁷ Paragrafi 115 i vendimit nr. 256, datë 12.06.2020, të Komisionit.

e të ardhurave për blerjen e pasurisë apartamentet banimi në Tiranë, duke marrë në konsideratë kursimet e subjektit nga të ardhurat e tij, shumën e përfituar nga kredia në vitin 2006, si dhe shpjegimet gjatë parashtrimeve, lidhur me kursin e këmbimit të përdorur prej saj në konvertimin e kursimeve nga lekë në euro, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit përballon me burime të ligjshme pagimin e kësaj shume, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për pasojë e gjen këtë pasuri të ligjshme, në kuptim të objektit dhe përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

19. Lidhur me shkakun e ankimit se, për burimin e krijimit “të ardhura nga kredia”, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit se është përdorur për pasurinë apartament në Tiranë, subjekti i rivlerësimit në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, trupë gjykues konstatoi sa më poshtë.
20. Komisioni, në vendim, në verifikim dhe kontroll të burimit të krijimit të sipërcituar të pasurisë “apartament”, ka çmuar se veprimet juridike të kryera nga subjekti i rivlerësimit, në funksion të përfitimit të një kredie me kushte lehtësuese për të financuar blerjen e së vetmes banesë që rezulton të ketë në pronësi të tij, nuk përbëjnë një aktivitet i cili duhet të konsiderohet se ka afektuar me paligjshmëri burimin e krijimit të pasurisë, apartament banimi, të ndodhur në Tiranë. Komisioni ka vlerësuar se pasaktësitë e konstatuara gjatë deklarimeve periodike vjetore nga subjekti i rivlerësimit, nuk konstatohet se mund të kenë pasur për qëllim fshehjen e ndonjë pasurie apo deklarimi të rremë lidhur me ligjshmërinë e burimeve të përdorura prej saj në blerjen e kësaj pasurie. Në vlerësim të Komisionit, në konsekuencë edhe të qëndrimeve tashmë të konsoliduara, të mbajtura nga Kolegji, pasaktësitë në deklarime nuk mund të shërbejnë si shkelje të tilla, që të formojnë bazën e duhur ligjore për shkarkim. Ky qëndrim, i mbështetur në analizim të parashikimeve të nenit 61, pika 3 që të drejtojnë te neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, është analizuar i parë ngushtë edhe me parashikimin në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, i cili kërkon si një parakusht për përgjegjësinë disiplinore për efekt të këtij procesi, përpjekjet e subjektit për defektimin e deklarimeve të tij në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, parakusht që përjashton pasaktësitë në deklarime, si një premisë për shkarkim, përveç rastit kur ato janë kryer me qëllim fshehjen e pasurisë apo deklarimin e pasaktë të të dhënave, përfshirë këtu edhe ato lidhur me burimet e krijimit të pasurisë, të cilat natyrshëm nuk mund të kualifikohen si pasaktësi, por si deklarime të rreme dhe fshehje e pasurisë ⁸.
21. Komisioneri Publik kundërshtoi si të pabazuar arsyetimin dhe konkluzionin e mësipërm të Komisionit, duke argumentuar se, nisur nga vlera provuese që marrin deklaramet vjetore të subjekteve të rivlerësimit, në referencë të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë vlerën e likuiditeteve gjendje në *cash*, jashtë sistemit bankar, në lekë ose valutë të huaj, si dhe çdo ndryshim të këtyre vlerave. Sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit, pas tërheqjeve nga llogaritë bankare të shumës së kredisë prej 5.000.000 lekësh në vitin 2007, nuk rezulton të ketë deklaruar në asnjë prej deklaratave periodike të interesave të viteve 2007 e 2008, posedimin e tyre *cash* në banesë ose përdorimin e tyre, në lekë apo në euro, duke bërë kështu të pamundur gjurmimin e këtyre të ardhurave gjatë viteve përkatëse. Në konkluzion të arsyetimit të mësipërm, Komisioneri Publik, lidhur me burimin e të ardhurave të deklaruara si zë për shlyerjen e kështit të parë në shumën prej 5.000.000 lekësh, si e ardhur nga kredia me kushte

⁸ Paragrafi 111 i vendimit nr. 256, datë 12.06.2020, të Komisionit.

lehtësuese, e marrë në vitin 2006, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.

22. Lidhur me këtë shkak të ankimit, në parashtrimet para Kolegjit, subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, prapësoi se pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me pasurinë objekt kontrolli, janë të pabazuara, duke argumentuar se shuma e lëvruar nga kredia bankare, në masën 5.000.000 lekë, ka kaluar në llogarinë e saj bankare pranë Raiffeisen Bank, në datën 25.09.2006 dhe është tërhequr *cash* në datën 03.11.2006. Në të njëjtën datë, për qëllim ruajtjeje, e ka depozituar në llogarinë pranë ProCredit Bank. Në momentin e kreditimit të shumës 5.000.000 lekë, ka deklaruar se burimi i saj është kredia e marrë nga Raiffeisen Bank. Në kushtet kur nuk kishte mundur ende të gjente një apartament të përshtatshëm në Tiranë për të banuar, kjo për faktin se apartamentet e pëlqyera prej saj nuk mund t'i përballonte financiarisht, ose ato që mund të përballonte ishin të papërshtatshme, shumën e kredisë e la në ruajtje pranë ProCredit Bank, deri më datë 30.04.2007, datë në të cilën llogaria pranë ProCredit Bank është zeruar, për shkak të tërheqjes së të gjithë shumës. Shumën e tërhequr, pra shumën e kredisë së marrë, e ka mbajtur gjendje *cash* në shtëpi, në pritje të realizimit të qëllimit për të cilin kishte marrë kredinë. Këtë shumë, prej 5.000.000 lekësh, sikurse ka deklaruar, e ka përdorur në vitin 2009, për pagimin e këstit të parë për blerjen e apartamentit në Tiranë. Duke qenë se kredinë bankare e ka deklaruar në deklaratat e interesave privatë periodikë/vjetorë, nga viti 2006 e në vazhdim, në zërin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” dhe nuk ka kryer asnjë veprim juridik gjatë asaj periudhe, shumën e kredisë e ka pasur gjendje *cash* në banesë deri në vitin 2009 dhe e ka vlerësuar si fakt të deklaruar, pa qenë e nevojshme ta deklaronte edhe në një zë tjetër të asaj deklarate, si gjendje *cash*. Sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Deda, veprimet e kryera prej saj janë të qarta dhe mosdeklarimi i gjendjes *cash* në fund të vitit 2007, ka qenë një pasaktësi e paqëllimshme.
23. Në funksion të shqyrtimit të këtij shkak të ankimit dhe njëkohësisht kontrollit të vendimmarrjes së Komisionit lidhur me vlerësimin e kredisë në shumën 5.000.000 lekë, si një nga burimet e krijimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi fillimisht se është i nevojshëm analizimi i çështjes, nëse mosdeklarimi i shumave të tërhequra nga kredia si gjendje *cash* në banesë, në deklaramet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në vitet 2007 e 2008, mund të prodhojë pasojat e një deklarimi të pasaktë dhe të pamjaftueshëm e, për pasojë, të afektojë me paligjshmëri këtë burim krijimi.
24. Në funksion të kësaj çështjeje të shtruar për zgjidhje, trupi gjykues, nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, konstatoi si vijon.

24.1 Me kontratën e kredisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.09.2006, të lidhur me Raiffeisen Bank⁹, subjekti i rivlerësimit ka përfituar një kredi në shumën 5.000.000 lekë. Sipas përmbajtjes së kësaj kontrate, qëllimi i dhënies së kredisë ishte përdorimi i saj për blerje apartamenti¹⁰. Kredia akordohej për një afat prej 168 muajsh dhe afati fillonte që nga dita e disbursimit të parë¹¹. Nga norma e interesit të aplikuar prej 12%, kredimarrësi, subjekti i rivlerësimit, do të paguante normë interesi 3% mbi shumën, ndërsa pjesa tjetër e interesit do të paguhej nga Ministria e Financave, në zbatim të marrëveshjes nr. {***} prot., datë 20.06.2005,

⁹ Të dhëna që rezultojnë nga dokumentacioni bankar i përcjellë në Komision nga Raiffeisen Bank, me shkresën nr. {***} prot., datë 28.02.2019 dhe shkresën nr. {***} prot., datë 20.11.2019.

¹⁰ Neni 1, pika 1.1 e kontratës së kredisë.

¹¹ Neni 2, pika 2.1 e kontratës së kredisë.

ndërmjet Raiffeisen Bank dhe Ministrisë së Financave, për trajtimin me strehim të funksionarëve të lartë të shtetit¹².

24.2 Referuar lëvizjeve të llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit në Raiffeisen Bank, si dhe atyre në ProCredit Bank¹³, rezulton se:

- (i) më datë 25.09.2006, në llogarinë e pagës së subjektit të rivlerësimit në Raiffeisen Bank, është disbursuar kredia në shumën 5.000.000 lekë;
- (ii) më datë 03.11.2006, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr nga llogaria në Raiffeisen Bank shumën prej 5.000.000 lekësh, të cilën e ka derdhur në llogari bankare rrjedhëse, të hapur në ProCredit Bank në emër të tij;
- (iii) më datë 24.02.2007, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr nga llogaria bankare rrjedhëse në ProCredit Bank, shumën 2.500.000 lekë;
- (iv) më datë 26.02.2007, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr nga llogaria bankare rrjedhëse në ProCredit Bank, shumën 1.000.000 lekë;
- (v) më datë 21.04.2007, është kredituar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në ProCredit Bank, shuma prej 2.500.000 lekësh;
- (vi) më datë 30.04.2007, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr *cash*, nga llogaria në ProCredit Bank, shumën 2.000.000 lekë;
- (vii) më datë 30.04.2007, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr *cash*, shumën 2.000.000 lekë dhe është zeruar llogaria në ProCredit Bank.

24.3 Me anë të kontratës së porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.10.2009, lidhur me shoqërinë sipërmarrëse “{***}” ShPK, subjekti i rivlerësimit ka porositur ndërtimin e një apartamenti me sipërfaqe 115 m², në rrugën “{***}”. Sipas nenit 2 të kësaj kontrate, vlera e apartamentit është 92.000 euro, nga të cilat 72.000 euro janë likuiduar jashtë zyrës noteriale në të cilën është nënshkruar kontrata, ndërsa shuma prej 20.000 eurosh do të likuidohej me kryerjen e aktit përfundimtar të shitblerjes së pronës.

Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.11.2011, administratori i shoqërisë “{***}” ShPK deklaroi se ka marrë nga subjekti i rivlerësimit shumën totale prej 92.000 eurosh, jashtë zyrës noteriale, për blerjen e apartamentit në Tiranë, shumë që rrjedh nga kontrata e porosisë së datës 09.10.2009.

Pasuria “apartament” i ka kaluar në pronësi subjektit të rivlerësimit, me lidhjen e kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.12.2011, në të cilën pranohet se çmimi i shitjes prej 92.000 eurosh, është marrë tërësisht nga shoqëria “{***}” ShPK, ndërsa subjekti i rivlerësimit ka marrë në dorëzim apartamentin.

Pasuria “apartament” është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, me nr. {***}, ZK {***}, Tiranë, më datë 13.12.2011 dhe me anë të kontratës së hipotekës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.11.2013, të lidhur mes Raiffeisen Bank dhe subjektit të rivlerësimit, është vendosur si kolateral për kredinë e marrë në këtë bankë, në shumën 5.000.000 lekë¹⁴.

24.4 Nga verifikimi i deklaratave periodike të interesave, të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, rezultoi se:

¹² Neni 3, i kontratës së kredisë.

¹³ Të dhëna që rezultojnë nga dokumentacioni bankar i përcjellë në Komision nga ProCredit Bank, me shkresën nr. {***} prot., datë 26.02.2019 dhe shkresën nr. {***} prot., datë 20.11.2019.

¹⁴ Sipas informacionit të përcjellë në Komision nga ZVRPP Tiranë, me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 13.03.2019.

i. Në deklaratën periodike të vitit 2006, ka deklaruar: *Më datë 18.09.2006, kam lidhur me Raiffeisen Bank Sh.A., kontratën e kredisë bankare për blerje apartamenti, me nr. {***} rep., nr. {***} kol.. Shuma totale e kredisë është 5.000.000 lekë, plus 3% normë interesi. Data e fillimit të detyrimit ishte 25.09.2006. Afati i kredisë është 168 muaj. Shuma e shlyer 109.454 lekë. Këstet prej 36.484 lekësh në muaj, për 163 muajt e mbetur.*

ii. Në deklaratat periodike të interesave në vitet në vijim, deri në plotësimin e deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar shlyerjen e kësaj kredie dhe vlerën e mbetur të detyrimit, si dhe qëllimin e marrjes së saj “për blerje apartamenti”.

iii. Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2009, ka deklaruar: *Më datë 09.10.2009, kam lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK, kontratën e porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., ku kam porositur një apartament banimi me sipërfaqe 115 m², në kat të pestë banimi, seksioni {***}, në pozicionin jugperëndim, e ndodhur si pronë në rrugën “{***}”, Tiranë. Shuma totale e apartamentit është 800 euro/m² e në total shuma e përgjithshme është 92.000 euro. Kam likuiduar këstin e parë prej 72.000 eurosh dhe këstin e dytë prej 20.000 eurosh do e likuidoje me kryerjen e aktit të shitblerjes së pronës, sipas ligjit.*

iv. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratat periodike të viteve 2006, 2007 dhe 2008, ka deklaruar kursime nga paga, por nuk deklaruar posedimin në cash të shumës prej 5.000.000 lekësh, të përfituar nga kredia bankare e dhënë nga Raiffeisen Bank dhe e tërhequr cash prej saj pas depozitimit në ProCredit Bank.

24.5 Gjatë hetimit administrativ në Komision, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të Komisionit¹⁵, në përgjigjet e datës 21.01.2020¹⁶ mbi një pyetje të drejtuar nga Komisioni lidhur me *kredinë prej 5.000.000 lekësh dhënë nga Banka Raiffeisen*, si dhe në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, të përcjella në Komision e të regjistruara në këtë të fundit me nr. {***} prot., datë 20.05.2020, në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në parashtrimet e paraqitura në Kolegj.

25. Në analizë të pretendimit të Komisionerit Publik, lidhur me çështjen e shtruar për zgjidhje, në analizë të kuadrit ligjor lidhur me detyrimin e subjekteve për deklarim të pasurisë dhe interesave privatë, trupi gjykues vëren se, sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, subjekti i rivlerësimit duhej të deklaronte pranë organit kompetent, ndër të tjera, vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash jashtë sistemit bankar, si dhe detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj. Në vlerësim të përmbushjes së detyrimit për deklarim sipas kuadrit të mësipërm ligjor, nga shqyrtimi i deklarimeve periodike të subjektit të rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, rezulton se kontratën e kredisë bankare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.09.2006, të lidhur me Raiffeisen Bank, për shumën totale të kredisë prej 5.000.000 lekësh, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar rregullisht në deklaratat periodike të interesave nga viti 2006 e në vijim, deri në plotësimin e deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, duke deklaruar shlyerjen e kësaj kredie dhe vlerën e mbetur të detyrimit, si dhe duke evidentuar qëllimin e marrjes së saj “për blerje apartamenti”. Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë detyrim është në përputhje me dokumentacionin e përcjellë nga Raiffeisen Bank në Komision. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me marrjen e kredisë dhe detyrimin e shlyer vit pas viti ndaj Raiffeisen Bank, është deklarim i saktë në përputhje me detyrimin ligjor sipas nenit 4, shkronja “dh” e ligjit nr. 9049/2003.

¹⁵ Përgjigjja e pyetjes nr. {***} të pyetësorit. Përgjigjet e përcjella nga subjekti i rivlerësimit në Komision janë regjistruar në këtë të fundit me nr. {***} prot., datë 27.11.2019.

¹⁶ Përgjigjja e përcjellë nga subjekti i rivlerësimit në Komision është regjistruar në këtë të fundit me nr. {***} prot., datë 23.01.2020.

26. Nga verifikimi në vijim i deklarimeve pranë ILDKPKI-së, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar se shumat e disbursuara nga kredia i ka tërhequr dhe i ka mbajtur si para *cash* në banesë në vitet 2007 dhe 2008. Edhe në deklaratën e vitit 2009, në deklarimin e marrëdhënies së krijuar me shoqërinë “{***}” ShPK, me rastin e lidhjes së kontratës së porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., 09.10.2009, për apartament banimi me sipërfaqe 115 m² në Tiranë, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit për likuidimin e këstit të parë prej 72.000 eurosh. Në këto kushte, konstatimi i Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratat e pasurisë së viteve 2007 dhe 2008, për shkak të mosdeklarimit të disponimit në *cash* të shumës prej 5.000.000 lekësh, të tërhequr nga disbursimi i kredisë, është një konstatim i drejtë, pasi mënyra e deklarimit të subjektit nuk përputhet me parashikimin e nenit 4, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016.

27. Trupi gjykues mori në analizë çështjen nëse pasaktësia për shkak të mosdeklarimit në deklaratimet periodike, si gjendje në *cash* e shumës së marrë nga kredia, afekton deklarimin e subjektit në deklarimin e pasurisë së rivlerësimit, duke e bërë atë, përveçse të pasaktë, edhe të pamjaftueshëm, referuar situatës faktike të rezultuar nga tërësia e akteve të administruara gjatë hetimit administrativ të kryer në Komision, e të pasqyruar në paragrafin 23, më sipër në këtë vendim. Trupi gjykues konstatoi se mosdeklarimi i këtij fakti juridik nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimet periodike, nuk pamundësoi institucionet e rivlerësimit për kontrollin dhe verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve të tij në deklaratën e rivlerësimit, lidhur me pasurinë e deklaruar dhe mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e saj, për sa kohë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar ekzistencën e kredisë dhe qëllimin e marrjes së saj, në mënyrë konstante, në çdo deklarim periodik, kredi e cila ka shërbyer për blerjen e pasurisë së vetme të subjektit të rivlerësimit, në përputhje të plotë me qëllimin dhe objektin e kredisë. Për rrjedhojë, trupi gjykues, pasi çmoi të ritheksojë vlerën që kanë deklaratimet e mëparshme të subjekteve të rivlerësimit, në vijim edhe të asaj që është theksuar në jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Kolegjit, arriti në konkluzionin se pasaktësia e deklarimeve periodike, në rastin konkret, nuk përbën shkak për deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë objekt kontrolli, deklaruar saktë e plotësisht në deklaratën e rivlerësimit, pasi nuk ka rezultuar asnjë e dhënë, sipas së cilës mosdeklarimi i posedimit në *cash* të shumës prej 5.000.000 lekësh në vitet 2007 dhe 2008 dhe përdorimi i saj në vitin 2009, të ketë shërbyer për fshehjen e veprimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, në kundërshtim me detyrimet e tij, sipas legjislacionit në fuqi, për deklarimin e pasurive. Gjithashtu, nga hetimi administrativ, nuk rezultoi e provuar që me këtë veprim (mosdeklarimin në deklaratat e viteve 2007 e 2008 të disponimit në *cash* të së ardhurës nga kredia), subjekti i rivlerësimit të ketë pasur si qëllim të mbajë jashtë vëmendjes dhe kontrollit të organit kompetent (ILDKPKI-së) këto pasuri të luajtshme dhe veprimet lidhur me to, në formën e deklarimit të rremë.

Në arsyetimin e mësipërm, me fokus pretendimin e Komisionerit Publik se mosdeklarimi i të ardhurave nga kredia si gjendje *cash* në banesë ose përdorimi i tyre bën të pamundur gjurmimin e këtyre të ardhurave gjatë viteve, trupi gjykues pati në konsideratë, në mënyrë integrale e në harmoni me njëra-tjetrën, rrethanat si vijojnë.

i. Pasuria “likuiditet *cash* në banesë” ka në origjinë dhe njëkohësisht burim krijimi marrëdhënien juridike të kredisë mes subjektit të rivlerësimit dhe Raiffeisen Bank, të lindur në vitin 2006, duke përbërë për rrjedhojë një burim të ligjshëm, i vlerësuar si i tillë edhe nga Komisioni dhe i pakontestuar nga Komisioneri Publik. Kjo kredi është deklaruar që në deklaratën periodike të vitit 2006 e në të gjitha deklaratat periodike në vitet në vijim, duke u deklaruar në mënyrë konsekuente dhe qëllimi i marrjes dhe destinacioni i përdorimit të saj *për blerje apartamenti* – deklarim ky që rezultoi të jetë i njëjtë me atë të deklaruar në deklaratën e pasurisë

së rivlerësimit, duke bërë të besueshëm këtë deklaram të fundit, referuar vlerës provuese që kanë deklaratat periodike të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në deklaratat periodike gjenden gjurmë të rrethanave faktike të pretenduara nga subjekti në deklaratën e rivlerësimit, duke rezultuar kështu se deklarata e rivlerësimit nuk është i vetmi dokument në të cilin gjejnë pasqyrim këto fakte.

ii. Mosdeklarimi i gjendjes së këtyre parave si gjendje *cash* në vitet 2007 e 2008, sipas shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe gjatë gjykimit në Kolegj, ka ardhur pikërisht si pasojë e perceptimit të tij se, duke deklaruar kredinë dhe destinacionin e saj, kishte përmbushur detyrimin për deklarim. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit duken bindëse, në kushtet kur këto likuiditete të cilat nuk janë krijuar nga kursime të saj, por burojnë nga një marrëdhënie e ligjshme kredie, në fakt nuk kanë pësuar shtim apo pakësim në momentin e disponimit *cash*, por vetëm kanë ndryshuar vendin e ruajtjes së tyre, nga banka në banesë.

iii. Nga verifikimi i marrëdhënies kontraktuale të krijuar mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, sipas përmbajtjes së kontratës së porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.10.2009, porositësja Etleva Deda ka likuiduar këstin e parë të blerjes së apartamentit prej 72.000 eurosh *jashtë zyrës noteriale*, pra, përpara shprehjes së vullnetit për lidhjen e kontratës te noteri publik, çka demonstroi se subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, ka pasur të disponueshme shumën prej 5.000.000 lekësh, të përfituar nga kredia e marrë me qëllim *blerje apartamenti*. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike, në lidhje me kohën e kryerjes së pagesave për blerjen e kësaj pasurie, nuk devijojnë nga ajo çka provohet me dokumentacionin kontraktual, i cili vërteton blerjen e saj.

iv. Nga verifikimi i kujdesshëm i akteve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, nuk rezultoi asnjë e dhënë sipas së cilës, gjatë periudhës prill 2007 - tetor 2009¹⁷, një periudhë relativisht e shkurtër e ruajtjes në *cash* të shumës së rrjedhur nga kredia, subjekti i rivlerësimit të ketë krijuar pasuri të tjera të asnjë lloji: pasuri të paluajtshme apo të luajtshme, si: automjet, depozita bankare etj., apo të ketë kryer shpenzime që do të justifikonin ndryshimin e destinacionit të përdorimit të shumës së disponuar nga tërheqja e kredisë. Nga verifikimi i sistemit TIMS, nuk rezultoi që subjekti të ketë kryer lëvizje/udhëtime jashtë vendit në këtë periudhë, që të orientojnë drejt shpenzimit të shumës së tërhequr nga kredia¹⁸. E njëjta situatë rezultoi edhe për personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit, të cilët gjatë kësaj periudhe nuk kanë krijuar pasuri të luajtshme e të paluajtshme, apo të kenë kryer udhëtime jashtë vendit¹⁹, duke shuar dyshimin që shuma prej 5.000.000 lekësh të jetë përdorur prej tyre.

v. Nga informacioni i përcjellë nga ZVRPP Tiranë, rezultoi se pasuria, apartament me sipërfaqe 115 m² në Tiranë, vazhdon ende të jetë *e vetmja* pasuri e paluajtshme e subjektit të rivlerësimit, e cila sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme, është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit më datë 13.12.2011 dhe është bllokuar në favor të Raiffeisen Bank, sipas kontratës së hipotekimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.11.2013, duke shërbyer kështu si kolateral për kredinë e marrë për blerjen e saj, duke rezultuar ky jo vetëm një veprim i nevojshëm për të garantuar kredinë, por një e dhënë që apartamenti është blerë realisht prej subjektit të rivlerësimit.

¹⁷ Periudhë gjatë së cilës subjekti i rivlerësimit pretendon se shumën e tërhequr të kredisë e ka pasur gjendje “*cash*” në banesë.

¹⁸ Subjekti i rivlerësimit në periudhën, prill 2007 - tetor 2009, ka kryer: (i) 3 udhëtime në vitin 2008, prej të cilave dy udhëtime janë kryer me autobus në dalje nga pikat kufitare Qafë Thanë e Murriqan dhe një udhëtim drejt Mynihut; (ii) 2 udhëtime në vitin 2009, një me autoveturë në dalje nga pika kufitare Hanit të Hotit dhe një me linjë ajrore drejt Ljubjanës.

¹⁹ Z. B. D. dhe znj. I. D., në periudhën prill 2007 - tetor 2009, kanë kryer: 4 udhëtime në vitin 2009, prej të cilave tri janë kalim pa automjet, me këmbë, në pikën kufitare Qafë Thanë dhe një me autoveturë, në pikën kufitare Tushemisht.

vi. Trupi gjykues vlerësoi se nuk mund të lihet pa vënë re dhe fakti se nga autoritetet ndihmëse për kontrollin e kriterit të figurës, nuk është raportuar asnjë dyshim apo indicie për përfshirje të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive, të cilat mund të shërbenin për të lëkundur bindjen se subjekti i rivlerësimit, në kushtet kur nuk ka deklaruar gjendjen *cash* në banesë të shumës prej 5.000.000 lekësh, të rrjedhur nga kredia, do ta kishte shpenzuar atë dhe, për pasojë, pagesa e kështit të parë prej 72.000 eurosh, do të buronte nga burime të paignifikuara.

28. Nga sa më sipër, për sa i përket vërtetësisë së deklaramit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, lidhur me përdorimin e kësaj kredie si burim për blerjen e apartamentit, në kuptim të parashikimit të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pas analizimit të tij në raport me të gjitha rrethanat e faktit të cituara më sipër, të cilat qëndrojnë në harmoni dhe në pajtueshmëri të dukshme me njëra-tjetrën, në përputhje me kriterin e vendosur nga neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arriti në konkluzionin se, nën frymën e një shqyrtimi objektiv të çështjes, deklarimi i subjektit të rivlerësimit se një nga burimet për krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 115 m², në Tiranë, është kredia me kushte lehtësuese e marrë në Bankën Raiffeisen, është një deklaram bindës dhe i besueshëm.
29. Qëndrimi i mësipërm u orientua edhe nga jurisprudenca e Kolegjit²⁰ në raste të ngjashme kur janë verifikuar deklaramet e kredive apo likuiditeteve, të rrjedhura nga burime të ligjshme të krijimit të pasurive, për të cilat subjektet e rivlerësimit nuk kanë deklaruar disponimin e tyre *cash* në banesë në fund të vitit.
30. Për këto arsye, ky pretendim i Komisionerit Publik u gjet i pabazuar në ligj dhe në fakte.
31. Në lidhje me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik sipas të cilit, *lidhur me burimin e deklaruar, të ardhura nga paga, përdorur për pasurinë apartament me sipërfaqe 115 m² në Tiranë, subjekti i rivlerësimit, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm*, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi si më poshtë.
32. Komisioni, në vendim²¹, në verifikim dhe kontroll të këtij burimi krijimi të pasurisë apartament, ka arsyetuar: *[...] pavarësisht pasaktësive të konstatuara në deklaramet periodike vjetore, lidhur me deklaramin mbi gjendjen “cash” dhe kundërshtive të konstatuara mes të dhënave lidhur me deklaramin e gjendjes deri më 31 dhjetor dhe deklaramit nga vetë subjekti mbi përdorimin e kursimeve për blerjen e apartamentit, i cili është në një datë më të shpejtë, të gjitha faktet e servitura mbeten të lidhura mes tyre dhe justifikojnë deklaramet e subjektit se ato kursime janë përdorur për blerjen e apartamentit (pagimin e kësteve përkatëse). Nëse ndjekim logjikën e deklarameve ndër vite dhe atë “vetting” lidhur me gjendjen “cash”, deklaramet e znj. Etleva Deda, përgjatë procesit të rivlerësimit të saj, gjejnë harmoni me situatën e pasqyruar në deklaramin “vetting”. Nga vëzhgimi i deklaramave periodike, evidentohet se pas pagimit të kësteve të apartamentit, përkatësisht në vitin 2009 dhe 2011, subjekti nuk ka deklaruar më kursime dhe as gjendje “cash” dhe, në vijim, vjen në deklaramtën “vetting” pa kursime dhe gjendje “cash” në banesë. Situatë e cila vjen në harmoni me logjikën e shpjegimeve të subjektit, pasi nëse kursimet nuk do të ishin përdorur, apo nga Komisioni nuk do të pranoheshin shpjegime bindëse, do të kishim një analizë financiare të çekuilibruar, ku gjendja “cash” e deklaruar më herët, e papranuar si e*

²⁰ Vendimi nr. 33/2021 (JR), datë 03.11.2021, paragrafi 44; vendimi nr. 37/2021 (JR), datë 24.11.2021, paragrafi 10.25; vendimi nr. 20/2022, datë 14.06.2022, paragrafi 14.

²¹ Paragrafët 99-103 të vendimit nr. 256, datë 12.06.2020, të Komisionit.

përdorur në vitet 2009-2011, do të ishte akumuluar si gjendje “cash” në vitin 2017, dhe do të ishte në kundërshti me deklarinimin “vetting” të subjektit të rivlerësimit. Pranimi i shpjegimeve të subjektit, gjen harmoni me mënyrën se si ajo deklaroi në DPV, ku subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi pakësime apo shtesa sipas detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 9049/2003 dhe në vijim, nëse gjendja “cash” nuk do të ishte përdorur, siç ajo shpjegon se ka ndodhur, këto kursime do të duhej të ishin deklaruar si gjendje “cash” në deklarinimin “vetting”. Komisioni analizoi deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike, në këndvështrim të dispozitave të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe situatës faktike konkrete. Sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, subjektet deklaruese kanë detyrimin të deklarojnë çdo shtesë të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, duke e përshkruar atë hollësisht dhe burimin e krijimit të saj. Në vlerësim të deklarinimeve dhe fakteve të prezantuara më sipër, Komisioni çmon se situata faktike nuk është deklaruar saktë në kuptim të ligjit nr. 9049/2003, nga subjekti i rivlerësimit. Në vlerësim të sa më sipër, megjithëse Komisioni i gjen deklarinimet periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit, lidhur me gjendjen “cash” dhe përdorimin e tyre, jo në përputhje me ligjin nr. 9049/2003, në përfundim vlerëson se ato janë pasaktësi të paqëllimshme dhe se deklarinimet e subjektit në deklaratën “vetting” ndihmojnë për të kuptuar drejt deklarinimet e tij ndër vite.

33. Në kundërshtim të këtij arsytimi të Komisionit, Komisioneri Publik, në ankim, ka argumentuar se:

a. nga përlllogaritja financiare e vitit 2006, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme kursimin e deklaruar, me një diferencë negative prej -150.999 lekësh, duke konsideruar se shuma e deklaruar si kursim është krijuar gjatë vitit 2006;

b. nga përlllogaritja financiare për periudhën 01.01.2009 deri më 09.10.2009, subjekti i rivlerësimit rezultoi me pamjaftueshmëri financiare në shumën prej -376.843 lekësh që, me kursime nga të ardhurat nga paga, të paguajë këstin e parë të apartamentit. Subjekti i rivlerësimit, sa më sipër analizuar, rezultoi me një diferencë negative totale për pagesën e kështit të parë në shumën -526.843 lekë, përfshirë këtu dhe diferencën negative të konstatuar për kursimet e deklaruara nga paga në vitin 2006;

c. nga përlllogaritja financiare, nga data 09.10.2009 deri më 31.12.2009, subjekti i rivlerësimit rezultoi me pamjaftueshmëri për të mbuluar me të ardhura të ligjshme kursimin e deklaruar në shumën 400.000 lekë, me një diferencë negative në shumën -252.770 lekë. Nëse kësaj diference i shtohet rezultati i analizuar për periudhën 01.01.2009 - 09.10.2009, diferenca negative e vitit 2009 rezultoi në shumën prej - 629.613 lekësh.

34. Lidhur me këtë shkak të ankimit, në parashtrimet para Kolegjit, subjekti i rivlerësimit prapësoi se pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me këtë burim krijimi të pasurisë apartament, nuk qëndrojnë, pasi:

a. Në deklarinimin periodik të vitit 2006 dhe në të gjitha deklaratat e tjera ndër vite, në të cilat ka deklaruar kursime, ka specifikuar se kursimet janë krijuar gjatë vitit kalendarik, pra në periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor të atij viti. Referuar faktit që për vitin paraardhës 2005, nuk ka deklaruar kursime nga paga edhe pse e ka pasur një mundësi të tillë, shumën e kursimeve të deklaruara për vitin 2006, në masën 1.000.000 lekë, e ka pasur gjendje më 31 dhjetor 2006, por një pjesë e tyre është krijuar në vitin paraardhës.

b. Kursimet nga paga të siguruara deri në vitin 2009, duke përfshirë edhe kursimet e atij viti, i ka zeruar për pagimin e kështit të parë të blerjes së apartamentit në Tiranë. Kursimet e deklaruara në vitin 2009, pavarësisht se nuk i ka pasur gjendje *cash* më 31 dhjetor të vitit respektiv, pasi i ka shpenzuar për të likuiduar pjesërisht këstin respektiv të çmimit të blerjes së apartamentit, i ka

deklaruar pikërisht se kanë shërbyer si burim krijimi për këtë pasuri. Kursimi i deklaruar për vitin 2009, duhet të analizohet për të gjithë vitin kalendarik, edhe pse *de facto* është realizuar nga data 01.01.2009 deri më datë 09.10.2009.

c. Në analizën financiare të kryer nga Komisioneri Publik, është konvertuar monedha “lekë” në “euro” me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së pagesës, duke mos vlerësuar shpjegimet e subjektit mbi këtë fakt. Nëse këmbimi i “lekut” në “euro” do të llogaritej me mesataren e kursit të këmbimit të asaj periudhe, jo vetëm rezulton mbulimi plotësisht i këstit të parë të apartamentit, por rezulton dhe një tepricë pozitive.

35. Në analizë të pretendimit të Komisionerit Publik mbi kursimet në *cash* të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e vitit 2006, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e përcjella nga Komisioni dhe vlerësoi pretendimet e Komisionerit Publik mbi situatën faktike, si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë shkak ankimi, konstatoi si më poshtë.

35.1 Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi për pasurinë, apartament me sipërfaqe 115 m², të ardhura nga paga të siguruara nga puna ndër vite, të përshkruara në këtë deklaratë.

35.2 Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të përcjella nga ILDKKPKI-ja në Komision, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime nga paga, për herë të parë, në deklaratën e pasurisë së vitit 2006, si vijon: *Kursime nga paga për periudhën e punës si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, deri në dhjetor 2006, vlera 1.000.000 lekë.*

35.3 Bazuar në të dhënat e “Formularit të vetëvlerësimit profesional²²” dhe vërtetimit nr. {***} prot., datë 12.01.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda²³, subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, ka filluar punë si gjyqtare pranë kësaj gjykate, më datë 01.03.2004.

35.4 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në parashtrimet gjatë gjykimit në Kolegj, është i njëjtë me atë që ka mbajtur gjatë hetimit administrativ në Komision, lidhur me mënyrën e interpretimit të deklarimeve periodike mbi kursimet e deklaruara në *cash*.

36. Në analizë të deklarimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë të vitit 2006, dhe në këndvështrim të dispozitave të ligjit nr. 9049/2003, trupi gjykues vëren se sipas parashikimeve të neneve 4 dhe 7 të këtij ligji, subjektet deklaruese kanë detyrimin të deklarojnë çdo ndryshim të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, duke e përshkruar atë hollësisht, si dhe burimin e krijimit të saj. Në deklaratën periodike të interesave, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se burimi i krijimit të kursimeve prej 1.000.000 lekësh janë të ardhurat nga paga për periudhën e punës si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, deri në dhjetor 2006, ndërsa në deklaratën periodike të vitit 2005, por edhe në atë të vitit 2004, vite në të cilat ka punuar si gjyqtare pranë së njëjtës gjykatë, nuk ka deklaruar kursime në *cash*. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime në *cash* as në deklaratën periodike të interesave të vitit 2003. Ndodhur në këto rrethana, në konsideratë të pretendimeve të Komisionerit Publik, si edhe të deklarimeve që ka bërë subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit në Kolegj, konsekuente me shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues vlerësoi se deklarimi i vitit 2006 duhet lexuar e interpretuar si korrigjim i atij të vitit 2005, për sa kohë objekt i verifikimit janë deklarimet periodike të interesave të deklaruara më parë në ILDKPKI, të cilat, në bazë të nenit 32, pika 5 e

²² Dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit pranë KLD-së, më datë 25.01.2017.

²³ Paraqitur nga subjekti i rivlerësimit si dokumentacion justifikues, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit.

ligjit nr. 84/2016, mund të shërbejnë si provë në këtë proces, e për sa kohë që pavarësisht pasaktësisë në deklarinimin e vitit 2005, nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi që të krijojë kursime në *cash* nga të ardhurat nga paga, madje një mundësi të tillë e ka pasur edhe në vitet 2003 e 2004. Në mbështetje të këtij arsytimi dhe vlerësimi të ndryshëm nga ai i Komisionerit Publik, nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezultoi se subjekti i rivlerësimit mund të krijonte me të ardhurat nga pagat, kursimet në vlerën 1.000.000 lekë deri në dhjetor të vitit 2006. Për rrjedhojë, në analizën financiare për verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për të krijuar me burime të ligjshme pasurinë objekt kontrolli, trupi gjykues mbajti në konsideratë shumën prej 1.000.000 lekësh si kursime në *cash*, të disponuara nga subjekti i rivlerësimit deri më datë 31 dhjetor 2006.

37. Në analizë të pretendimit të Komisionerit Publik, lidhur me kursimet në *cash* të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të interesave të vitit 2009, nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues konstatoi si vijon.

37.1 Në deklaratën periodike të vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kursime nga paga për periudhën e punës si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, nga janari deri në dhjetor të vitit 2007, vlera 350.000 lekë.*

37.2 Në deklaratën periodike të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kursime nga paga për periudhën e punës si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, nga janari deri në dhjetor të vitit 2008, vlera 300.000 lekë.*

37.3 Në deklaratën periodike të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kursime nga paga për periudhën e punës si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, nga janari deri në dhjetor të vitit 2009, vlera 400.000 lekë.*

38. Në analizë të pretendimit të Komisioneri Publik, trupi gjykues vëren se ai ka përllogaritur mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të paguar këstin e parë të apartamentit deri në datën e kryerjes së pagesës, më datë 09.10.2009. Komisioneri Publik referon se në analizën financiare të kryer deri më këtë datë, janë përfshirë: (i) kursimet *cash* të deklaruara nga subjekti në deklaratat e viteve 2006, 2007 dhe 2008, të krijuara me burim nga të ardhurat nga paga; (ii) 250.000 lekë të deklaruara në deklaratën e vitit 2007, si $\frac{1}{4}$ pjesë takuese e të ardhurave me burim shitjen e njësisë së shërbimit; si dhe (iii) të ardhurat nga paga për periudhën 01.01.2009 - 09.10.2009, duke zbritur shpenzimet e jetesës dhe shpenzimet për pagesat e kredisë, të kryera deri në datën 09.10.2009. Ndërsa në versionin e analizës për verifikimin nëse subjekti i rivlerësimit kishte mundësi që me të ardhurat nga paga, të krijonte kursimin e deklaruar *cash*, në shumën 400.000 lekë, për periudhën 09.10.2009 - 31.12.2009, Komisionerit Publik i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit kishte mungesë burimesh të ligjshme në shumën 252.770 lekë. Kësaj diference i është shtuar dhe rezultati e për periudhën 1.1.2009 - 9.10.2009, duke rezultuar në total në shumën prej - 629.613 lekësh. Kursi i këmbimit të konvertimit të këstit prej 72.000 eurosh në lekë, është përllogaritur nga Komisioneri Publik sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën 09.10.2009²⁴.
39. Në konsideratë të pretendimeve të mësipërme të Komisionerit Publik, si edhe deklarimeve që ka bërë subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore, në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision dhe në parashtrimet gjatë gjykimit në Kolegj, trupi gjykues vlerësoi se analiza e kryer nga Komisioneri Publik, në versionin se kursimi në *cash* prej 400.000 lekësh, është krijuar në periudhën 09.10.2009 - 31.10.2009, përbën një kapërcim logjik të deklarinimit të subjektit

²⁴ Referenca 16, në faqen 12 të ankimit të Komisionerit Publik.

të rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2009, se *kursimi është krijuar në periudhën 01.01.2009 - 31.12.2009*, deklarim i përdorur si referencë në arsyetimin e Komisionerit Publik. Kjo analizë duket edhe jo e arsyeshme, pasi balanca negative në shumën 629.613 lekë, është përlllogaritur si rezultat i analizimit të dy periudhave financiare në vijim të njëra-tjetrës, por me fokus të ndryshëm verifikimi: në periudhën e parë 01.01.2009 - 09.10.2009 është verifikuar mundësia e krijimit të këstit të parë të pasurisë apartament, duke përfshirë në të edhe kursimin e mundshëm në *cash* për këtë periudhë, ndërsa në periudhën e dytë 09.10.2009 - 31.12.2009, është verifikuar mundësia e krijimit të kursimeve në *cash* në shumën 400.000 lekë, e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit. Nga sa më sipër, rezulton se Komisioneri Publik, kursimin e mundshëm në *cash* të subjektit të rivlerësimit, e ka konsideruar të përdorur për pagesën e këstit të parë të apartamentit, por njëkohësisht edhe si gjendje në fund të vitit, në kundërshtim me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2009, se shuma prej 400.000 lekësh është krijuar gjatë gjithë vitit 2009, por edhe me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, përtej deklaratimit periodik pranë ILDKPKI-së, se kjo shumë është krijuar dhe është përdorur deri më datë 09.10.2009.

40. Trupi gjykues çmoi të verifikojë burimet financiare të subjektit të rivlerësimit për të krijuar kursimet në shumën 400.000 lekë, në dy versione.

Sipas *versionit të parë*, u verifikua mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit për të krijuar me burime të ligjshme të gjithë shumën, prej 400.000 lekësh, nga janari deri në dhjetor të vitit 2009, në përputhje me deklaratimin e bërë prej tij në deklaratën periodike të vitit 2009. Në këtë version të analizës, në ndryshim nga Komisioneri Publik, shuma prej 72.000 eurosh, e cila përbën pagesën e kryer për këstin e parë për blerjen e pasurisë apartament, u konvertua në monedhën “lekë” në shumën 9.349.500 lekë, me kursin mesatar të periudhës prill 2007 deri në tetor 2009, për shumën prej 57.000 eurosh dhe me kursin mesatar të javës së parë të muajit tetor 2009, për shumën 15.000 euro, të dhuruar nga babai në këtë periudhë²⁵, në vijim të përfundimit të arritur më sipër në këtë vendim, se shuma prej 5.000.000 lekësh, e përfituar nga kredia e marrë në Raiffeisen Bank, disponohej në *cash* nga subjekti i rivlerësimit. Balanca e fondeve sipas kësaj analize financiare të kryer në Kolegj, rezultoi negative në një vlerë prej 66.000 lekësh, balancë e cila u konsiderua nga trupi gjykues, e papërfillshme, për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve për krijimin e kursimeve në *cash*, në fund të vitit 2009.

Sipas *versionit të dytë*, i cili është edhe versioni garantist, në kuadër të vlerësimit të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e kontrollit të pasurisë, u verifikua mundësia që subjekti i rivlerësimit, shumën prej 400.000 lekësh, ta kishte krijuar në periudhën 01.01.2009 - 09.10.2009 dhe, për pasojë, ta kishte përdorur për pagesën e këstit të parë të apartamentit, ashtu siç ka pretenduar në shpjegimet e hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, se kursimet nga paga të siguruara deri në vitin 2009, duke përfshirë edhe kursimet e këtij viti, i ka zeruar për pagimin e këstit të parë të blerjes së apartamentit. Nga analiza financiare e kryer për këtë periudhë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, deri më datë 09.10.2009, mund të kursente shumën prej 500.225 lekësh, si diferencë mes të ardhurave dhe shpenzimeve të kësaj periudhe [pa përfshirë kryerjen e pagesës për apartamentin], për pasojë kishte mundësi që të përdorte shumën prej 400.000 lekësh, në pagesën e këstit të parë për pasurinë apartament.

41. Në përfundim, sipas analizës financiare të kryer në Kolegj, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dispononte të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar kursimet në *cash* të kontestuara

²⁵ Bazuar deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.04.2011²⁵, të z. B. D. dhe znj. I. D., të cilët kanë deklaruar se: “[...] në muajin tetor të vitit 2009, i kemi dhuruar vajzës sonë Etleva Deda, shumën prej 15.000 eurosh, për të plotësuar vlerën e blerjes prej saj të një apartamenti në Tiranë”.

nga Komisioneri Publik, për vitin 2006 dhe vitin 2009, kursime të cilat i ka përdorur, ndër të tjera, si burim krijimi për pagesën e këstit të parë të pasurisë, apartament në Tiranë.

42. Për pasojë, pretendimi i Komisionerit Publik u gjet i pabazuar në ligj dhe në fakte.
43. Në lidhje me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas të cilit: *personat e lidhur/tjerë të lidhur duket se nuk kanë shpjeguar në mënyrë të besueshme origjinën e ligjshme të shumës prej 15.000 eurosh, pasi nuk provohet me dokumentacion ligjor, në kuadër të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, aftësia financiare e tyre që, me burim nga të ardhura të ligjshme, të posedonin këtë shumë të dhuruar subjektit të rivlerësimit e të deklaruar si burim për pagesën e këstit të parë të pasurisë, apartament me sipërfaqe 115 m², trupi gjykues konstatoi si vijon.*
44. Komisioni, në vendim²⁶, në lidhje me shumën prej 15.000 eurosh, dhuruar subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Deda, nga prindërit e saj për blerjen e pasurisë apartament, ka arritur në konkluzionin: *Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shpjegime dhe prova të mjaftueshme lidhur me ligjshmërinë e shumës prej 15.000 eurosh, të dhuruar nga prindërit në vitin 2009, duke provuar mundësitë e tyre financiare për blerjen e apartamentit në Durrës në vitin 2003 dhe detyrimin për pagimin e tatimit mbi të ardhurat nga shitja e tij në vitin 2006.*
45. Komisioneri Publik, në ankim, ka kundërshtuar konkluzionin e mësipërm të Komisionit dhe ka parashtruar shkakun e ankimit, duke argumentuar:
 - a. shumën e dhuruar prej 15.000 eurosh, nuk plotëson kushtet e të ardhurave të ligjshme, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe praktikës së konsoliduar të Kolegjit mbi përkufizimin e të ardhurave të ligjshme si të ardhura të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, pasi në dosjen e Komisionit nuk dokumentohet pagesa e tatimit për të ardhurat nga dhurimi;
 - b. babai i subjektit të rivlerësimit është në cilësinë e personit të lidhur, në kuptim të nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, për këtë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, periudhë në të cilën ai ka qenë pjesë përbërëse e gjendjes familjare të subjektit, si dhe person tjetër i lidhur sipas nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, pasi ka pasur marrëdhënie interesi në formën e dhurimit me subjektin e rivlerësimit, për dhurimin e shumës prej 15.000 eurosh në vitin 2009 dhe të shumës prej 4.000 eurosh në vitin 2011, si burim për pagesën e këstit të dytë të apartamentit. Sa më sipër, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur u lind detyrimi të provojnë ligjshmërinë e shumës së dhuruar. Në rastin konkret, merr rëndësi fakti se vetë subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, ka deklaruar se një ndër burimet për krijimin e kësaj pasurie, kanë qenë të ardhurat e saj nga paga deri në fund të vitit 2004. Bazuar në përlllogaritjet përkatëse, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur/ të tjerë të lidhur rezultojnë me mungesë të të ardhurave të ligjshme në shumën totale prej 12.332 USD, për të blerë pasurinë, apartament me sipërfaqe 130 m², në Durrës, me çmim blerjeje 48.000 USD, pasuri e cila ka shërbyer si burim për krijimin e shumës së dhuruar prej 15.000 eurosh, për blerjen e apartamentit në Tiranë, në pronësi të subjektit të rivlerësimit.
46. Gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrimet mbi konkluzionet përfundimtare, Komisioneri Publik argumentoi se Kolegji në jurisprudencën e tij orientuese, të mëvonshme nga koha e paraqitjes së ankimit konkret, tashmë ka interpretuar në lidhje me verifikimin e burimit dhe ligjshmërinë e shumave monetare të dhuruara, parë kjo e fundit në raport me pagimin e tatimit për to, se e ardhura e përfituar nga dhurimi i vlerave monetare nuk listohet te kategoritë që bëjnë pjesë te “të ardhurat

²⁶ Paragrafi 114, faqe 28 e vendimit nr. 256, datë 12.06.2020, të Komisionit.

e tjera”, për të cilat mund të aplikohet tatimi në burim sipas shkronjës “g”, pika 1 e nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar²⁷. Për pasojë, trupi gjykues nuk ia nënshtroi shqyrtimit këtë shkak ankimi për kriterin e vlerësimit të pasurisë, i cili pas zhvillimit të hetimit e debatit gjyqësor, u gjet prej Komisionerit Publik si i pabazuar e, për rrjedhojë, u vlerësua nga trupi gjykues jashtë kufijve të shqyrtimit të çështjes.

47. Lidhur me këtë shkak të ankimit, në parashtrimet para Kolegjit, subjekti i rivlerësimit prapësoi se pretendimet e Komisionerit Publik për këtë burim krijimi të pasurisë apartament, nuk qëndrojnë, pasi *shuma e dhuruar nga prindërit, prej 15.000 eurosh, e ka burimin nga diferenca midis shitjes së një apartamenti me sipërfaqe 130 m² nga babai i saj kundrejt shtetasit Xh. B. në datën 04.12.2006, në shumën 9.000.000 lekë dhe blerjes nga babai i saj i një apartamenti me sipërfaqe më të vogël, në datën 15.12.2006, në shumën 5.300.000 lekë. Diferenca ndërmjet vlerës së shitjes së apartamentit dhe vlerës së blerjes së apartamentit tjetër është 3.700.000 lekë. Si apartamenti që z. B. D. i ka shitur shtetasit Xh. B., ashtu edhe ai i blerë nga babai i saj, edhe aktualisht janë apartamente të paregjistruara në DVASHK Durrës, nga shoqëritë respektive të ndërtimit. Apartamentin me sipërfaqe 130 m², shitur z. Xh. B., babai i subjektit të rivlerësimit e ka blerë nga shoqëria “{***}” ShPK, në vlerën 48.000 USD, nga të cilat kësti i parë 24.000 USD është paguar ditën e lidhjes së kontratës në praninë e noterit, ndërsa kësti i dytë 24.000 USD do të paguhej gjatë periudhës 2-vjeçare deri në dorëzimin e çelësave në dorë. Burimi i të ardhurave për blerjen e kësaj prone, kanë qenë: a) të ardhurat e subjektit të rivlerësimit deri në fund të vitit 2004; b) të ardhurat e prindërve të saj, B. dhe I. D., deri në fund të vitit 2004; si dhe c) të ardhurat e motrës së saj, znj. A. D., për periudhën janar 1994 - gusht 2000. Sipas subjektit të rivlerësimit, familja e saj ka pasur burime të mjaftueshme për blerjen e apartamentit në vitin 2004.*

48. Në shqyrtim të pretendimit të Komisionerit Publik, pasi verifikoi aktet e administruara nga Komisioni dhe ato të administruara gjatë gjykimit në Kolegj, trupi gjykues vlerësoi pretendimet e Komisionerit Publik mbi situatën faktike, si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë shkak ankimi dhe konstatoi si më poshtë.

48.1 Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.04.2011²⁸, z. B. D. dhe znj. I. D. kanë deklaruar se: *[...] në muajin tetor të vitit 2009, i kemi dhuruar vajzës sonë Etleva Deda shumën prej 15.000 eurosh, për të plotësuar vlerën e blerjes prej saj të një apartamenti në Tiranë. [...] më datë 04.12.2006, unë B. D. [...] i kam shitur shtetasit Xh. B. apartamentin 3+1, ndodhur në katin e pestë të ndërtimit, kundrejt çmimit prej 9.000.000 lekësh [...]. [...] më datë 15.12.2006, kam blerë një apartament 2+1 në katin e nëntë të ndërtimit, ku vlera e blerjes së apartamentit është 5.300.000 lekë të reja. Deklarojmë se shuma prej 15.000 eurosh, dhuruar vajzës sonë, buron nga diferenca e vlerës së shitjes së apartamentit të parë dhe vlerës së blerjes së apartamentit të dytë. [...] për shkak të marrëdhënieve të posaçme prindër-fëmijë, në momentin e dhurimit nuk kemi bërë akt noterial (kontratë dhurimi).*

48.2 Sipas kontratës së shitjes me kusht nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.08.2003, të lidhur mes shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShPK, në cilësinë e shitësit dhe z. B. D., në cilësinë e blerësit, shoqëria “{***}” ShPK i ka shitur z. B. D. një apartament me sipërfaqe përafërsisht 130 m² në Durrës, me çmimin prej 48.000 USD. Kësti i parë në vlerën prej 24.000 USD, është likuiduar në

²⁷ Paragrafët 23.13 - 23.18 të vendimit nr. 15/2021 (JR), datë 18.06.2021, të Kolegjit.

²⁸ ILDKPKI, në procesverbalin e mbajtur më datë 18.04.2011, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqesë deklaratën noteriale që konfirmon dhuratën nga prindërit në shumën 15.000 euro, si dhe të sqarohet në këtë deklaratë burimi i krijimit të këtyre të ardhurave. Subjekti i rivlerësimit, bazuar në kërkesën e ILDKPKI-së, ka dorëzuar deklaratën noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.04.2011.

dorë në zyrën e noterisë Durrës, në praninë e noterit, ndërsa kësti i dytë në shumën prej 24.000 USD do të likuidohet gjatë periudhës dyvjeçare deri në dorëzimin e çelësave në dorë. Sipas kontratës së sipërcituar, me regjistrimin e apartamentit në zyrën e regjistrimit të pasurive Durrës, shtetasit B. D. i lindte e drejta e realizimit të kontratës së shitblerjes dhe regjistrimit të pasurisë në emrin e tij.

48.3 Administratori dhe ortaku i vetëm i shoqërisë “{***}” ShPK, z. F. F., në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.05.2020, ka deklaruar, ndër të tjera, se z. B. D. ka likuiduar totalisht shumën prej 48.000 USD, ku 24.000 USD i ka paguar në datën 20.08.2003, në datën e lidhjes së kontratës së shitjes me kusht, dhe pjesën e mbetur e ka paguar në fund të vitit 2004, duke respektuar afatin 2-vjeçar të parashikuar në kontratë.

48.4 Në datë 04.12.2006, z. B. D., në cilësinë e shitësit, dhe z. Xh. B., në cilësinë e blerësit, kanë lidhur kontratën e shitjes me kusht nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.12.2006, për shitblerjen e një apartamenti me sipërfaqe 130 m². Ky apartament, për efekt procedure, nuk ishte regjistruar në ZVRPP Durrës, pasi nuk ishte realizuar regjistrimi fillestar nga shoqëria “{***}” ShPK, arsye për të cilën nuk ishte e mundur lidhja e një kontrate shitjeje, por midis palëve lidhej kjo kontratë shitjeje me kusht. Çmimi i shitjes prej 9.000.000 lekësh, është likuiduar totalisht në dorë, jashtë zyrës noteriale. Z. Xh. B., në cilësinë e blerësit, ka qenë dakord për blerjen e këtij apartamenti, me kushtin që kur të bëhet regjistrimi i apartamentit në ZRPP Durrës, të realizohet kontrata e shitblerjes së apartamentit për kalimin në pronësi të tij.

48.5 Me anë të kontratës së shitjes me kusht nr. {***} prot., datë 15.12.2006, e lidhur në zyrën e shoqërisë “{***}” ShPK Durrës, mes shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShPK, në cilësinë e shitësit, dhe z. B. D., në cilësinë e blerësit, ky i fundit ka blerë nga kjo shoqëri një apartament me sipërfaqe ndërtimi 110 m², në shumën 5.300.000 lekë, e likuiduar menjëherë nga blerësi. Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.10.2016, shoqëria “{***}” ShPK dhe z. B. D. kanë rënë dakord që kontrata për kalimin e pronësisë së apartamentit në favor të z. B. D., të realizohet pas regjistrimit të objektit në ZVRPP Durrës, në emër të shoqërisë në fjalë, duke iu përmbajtur të gjitha kushteve të përcaktuara në kontratën e shitjes me kusht të lidhur mes palëve më datë 15.12.2006.

48.6 Me anë të vërtetimit nr. {***}, datë 07.06.2022²⁹, drejtuar znj. E. D., DVASHK Durrës vërteton se apartamenti me sipërfaqe 130 m², ndërtuar nga shoqëria “{***}” ShPK, e cila ka ndryshuar emër në “{***}” ShPK, nuk figuron i regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, as në emër të shoqërisë së ndërtimit, as në emër të z. B. D., si dhe as në emër të z. Xh. B. apo trashëgimtarëve të tij. Në vijim, DVASHK Durrës sqaron se për pasojë, z. B. D. nuk i ka lindur detyrimi, madje as e drejta të paguajë tatim mbi fitimin e kalimit të pronësisë, pasi si detyrim që buron nga udhëzimi nr. 29, datë 30.07.2018, paguhet prej shitësit për pasuritë e paluajtshme, të cilat janë të regjistruara në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Sipas të njëjtit vërtetim, për pasuritë e paregjistruara, ky tatim paguhet në momentin e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme pranë ZVRPP-së, sot DVASHK-ja.

49. Në analizë të shkakut të ankimit, trupi gjykues vëren se Komisioneri Publik, për marrëdhënien e dhurimit të shumës prej 15.000 eurosh subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Deda, nga prindërit e saj, i vesh këta të fundit me statusin e personave të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 13 e ligjit nr.

²⁹ Akti i sipërcituar është paraqitur nga subjekti i rivlerësimit dhe është administruar në cilësinë e provës gjatë gjykimit në Kolegj, në seancën gjyqësore të datës 05.07.2022.

84/2016, për shkak të qenies së tyre pjesë përbërëse e gjendjes familjare të subjektit dhe njëkohësisht edhe me statusin e personave të tjerë të lidhur për shkak të marrëdhënies së interesit në formën e dhurimit, sipas parashikimit të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues vlerësoi se kualifikimi i prindërve të subjektit të rivlerësimit si persona të lidhur apo si persona të tjerë të lidhur, kushtëzon dhe vendos kufijtë e kontrollit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë së dhuruar, shumës prej 15.000 eurosh, objekt i ankimit të Komisionerit Publik. Në vlerësimin e trupit gjykues, personi i lidhur nuk përjashtohet nga mundësia e të qenit edhe person tjetër i lidhur sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por qartësimi i kualifikimit të prindërve të subjektit të rivlerësimit në njërin nga këto statuse, është i nevojshëm dhe ngushtësisht i lidhur me kufijtë e kontrollit ndaj pasurisë së tyre, në kuptim të parashikimeve kushtetuese dhe atyre ligjore për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar, për efekt të trajtimit të këtij shkakut ankimi.

50. Kualifikimin ligjor si persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, z. B. dhe znj. I. D., prindërit e subjektit të rivlerësimit, e kanë fituar për shkak të konfirmimit të subjektit për përfitimin e këtij dhurimi në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe në deklaratën periodike të interesave të vitit 2009, si dhe konfirmimit të dhurimit të shumës prej 15.000 eurosh në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.04.2011, të lëshuar për këtë qëllim nga z. B. D. dhe znj. I. D., të cilët kanë deklaruar se në muajin tetor të vitit 2009, i kanë dhuruar vajzës së tyre Etleva Deda, shumën prej 15.000 eurosh, për të plotësuar vlerën e blerjes prej saj të një apartamenti në Tiranë.
51. Trupi gjykues vëren se Komisioneri Publik, në ankim, ka parashtruar se kontratat e shitblerjes së pasurive nga babai i subjektit të rivlerësimit, nga diferenca e çmimit të të cilave është deklaruar burimi për shumën prej 15.000 eurosh, shërbejnë për të provuar ekzistencën e të ardhurave në momentin e dhurimit, por nuk shpjegojnë origjinën e ligjshme të krijimit të kësaj shume. Mundësia për të dhuruar me të ardhura të ligjshme shumën 15.000 euro, sipas Komisionerit Publik, duket se është e ndërvarur me justifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë, apartament me sipërfaqe 130 m², nga shitja e të cilit është deklaruar dhe burimi i shumës së dhuruar. Komisioneri Publik ka vlerësuar se personat e lidhur/e tjerë të lidhur duket se nuk kanë shpjeguar në mënyrë të besueshme origjinën e ligjshme të shumës prej 15.000 eurosh, pasi nuk provohet me dokumentacion ligjor, në kuadër të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, aftësia financiare e tyre, që me burim nga të ardhura të ligjshme, të posedonin këtë shumë të deklaruar dhuruar subjektit të rivlerësimit. Komisioneri Publik, shkakun e ankimit të tij në verifikimin e burimit të krijimit të pasurisë, apartament me sipërfaqe 130 m², e ka lidhur me shumën prej 15.000 eurosh të dhuruar subjektit nga prindërit, edhe në rastin kur këta të fundit i konsideron si persona të lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe thekson rëndësinë që merr fakti se vetë subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, ka deklaruar se një ndër burimet për krijimin e kësaj pasurie, kanë qenë të ardhurat e saj nga paga deri në fund të vitit 2004. Shkakun e ankimit të Komisionerit Publik ka qenë ngushtësisht i lidhur me verifikimin e shumës prej 15.000 eurosh, në raport me të cilën prindërit e subjektit kanë statusin e personave të tjerë të lidhur dhe nuk duket se dëshmon nevojën për verifikimin e krijimit të pasurisë, apartament me sipërfaqe 130 m², në cilësinë e prindërve të subjektit si persona të lidhur.
52. Në kushtet kur kërkimi dhe argumentimi i kryer nga Komisioneri Publik në ankim, i është referuar shumës prej 15.000 eurosh dhe është orientuar në mënyrë të shprehur drejt parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe detyrimin që ai përcakton për subjektet e rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur me ta, trupi gjykues vlerësoi se shtrirja e kontrollit mbi gjithë pasuritë e personave

që kanë marrëdhënie interesi me subjektin e rivlerësimit, do të përbënte një barrë disproporcionale për subjektin e rivlerësimit, për rrethanat në të cilat gjen zbatim neni 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, edhe në rastin kur personat e tjerë të lidhur janë njëkohësisht edhe persona të lidhur me subjektin e rivlerësimit. Ky vlerësim, në rastin konkret, u kushtëzua nga analizimi i aspekteve të veçanta të marrëdhënies mes subjektit të rivlerësimit dhe pasurisë, apartament me sipërfaqe 130 m², në pronësi të personit të lidhur, si vijon.

i. Subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, nuk ka qenë palë në asnjë nga kontratat e lidhura nga babai i saj për blerjen dhe shitjen e pasurive të paluajtshme, si rezultat i të cilave ka buruar shuma prej 15.000 eurosh.

ii. Kjo shumë është deklaruar në mënyrë konsekuente nga subjekti i rivlerësimit si dhurim nga prindërit dhe edhe këta të fundit kanë deklaruar se ia dhurojnë këtë shumë vajzës së tyre, pa e lidhur dhurimin me ndonjë kontribut të dhënë nga subjekti i rivlerësimit në blerjen e pasurisë, apartament me sipërfaqe 130 m², apo me ndonjë lloj shpërndarjeje të të ardhurave të krijuara nga shitja e kësaj pasurie.

iii. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ të Komisionit dhe gjatë gjykimit në Kolegj, se në analizën financiare për verifikimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie, duhet të përfshihen edhe të ardhurat e saj dhe të motrës së saj, znj. A. D., duket se është bërë në kuadrin e kontributeve të derdhura në familje si rezultat i jetesës së përbashkët dhe administrimit të të ardhurave të përbashkëta nga prindërit dhe jo në kuptim të një interesi pasuror për blerjen e një pasurie të përbashkët³⁰. Kjo mënyrë të konceptuari e kontributit të derdhur në familje nga subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, përkon edhe me deklarin e saj në deklaratën e interesave të vitit 2003, në të cilën ajo nuk ka deklaruar kursime në *cash*, si dhe me deklarin e subjektit në vitin 2006, në të cilin ka deklaruar kursime në *cash*, të cilat, siç ka shpjeguar gjatë hetimit administrativ në Komision, por edhe në Kolegj, i ka krijuar gjatë viteve 2005 dhe 2006, që indikon se pas vitit 2004, ajo ka krijuar kursime personale, duke kontribuar në familje vetëm me shpenzimet e jetesës së saj.

iv. Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë palë në kontratën e shitjes së pasurisë, apartament me sipërfaqe 130 m², dhe as nuk ka pretenduar të drejta pasurore nga shitja e kësaj pasurie për shkak të kontributit të derdhur në jetesën e përbashkët me familjen e saj, nga kursimet e së cilës prindërit kanë krijuar pasurinë gjatë jetesës së përbashkët dhe as nuk ka deklaruar në deklarinet periodike të interesave, të drejta pasurore mbi pasurinë, apartament me sipërfaqe 130 m², në Durrës.

v. Prindërit e subjektit të rivlerësimit janë persona të lidhur me subjektin e rivlerësimit³¹, por që nuk zotërojnë të drejta reale mbi ndonjë pasuri të paluajtshme të përbashkët me subjektin e rivlerësimit. Në këto kushte, nga tërësia e fakteve të provuara gjatë hetimit administrativ në Komision që burojnë nga burime të njohura të provës, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, nuk ka rezultuar asnjë e dhënë, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit të ketë kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në krijimin e pasurisë, apartament me sipërfaqe 130 m², në Durrës, me qëllim përfitimin e të drejtave reale mbi të.

³⁰ Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka deklaruar se: “Sa më sipër, në ndryshim nga përllogaritja e kryer nga Komisioni, duke qenë se kësti i dytë prej 24.000 USD është paguar në fund të vitit 2004, për llogaritjen e burimit të të ardhurave për blerjen e kësaj prone, duhet të llogariten edhe të ardhurat e mia e të prindërve të mi të vitit 2004. Burimi i të ardhurave për blerjen e kësaj prone, janë edhe të ardhurat e sime motre, shtetases A. D., për periudhën janar 1994 - gusht 2000, të cilat nuk janë përllogaritur nga Komisioni”.

³¹ Prindërit e subjektit të rivlerësimit janë persona të lidhur me subjektin e rivlerësimit për shkak të qenies në të njëjtën certifikatë familjare me të në kohën e plotësimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, pavarësisht se, sipas deklarin të subjektit gjatë hetimit administrativ në Komision, ajo ka jetuar me familjen e saj deri në fillim të vitit 2012, kur është zhvendosur për të jetuar e vetme, në apartamentin në pronësi të saj në Tiranë.

vi. Përveç sa më sipër, trupi gjykues vëren se ankimi i Komisionerit Publik, sikurse edhe hetimi i kryer nga Komisioni, nuk rezulton të kenë pasur për objekt dyshimin për pasuri të fshehur nga subjekti i rivlerësimit në emër të prindërve të saj.

53. Nën dritën e këtyre rrethanave, trupi gjykues vlerësoi se dhurimi i shumës prej 15.000 eurosh subjektit të rivlerësimit nga prindërit e saj, përmbush kriteret e përcaktuara nga ligji nr. 84/2016 për konceptin e personave të tjerë të lidhur. Për këtë arsye, verifikimi dhe kontrolli i saj duhet të fokusohet brenda kufijve të parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, trupi gjykues gjeti me vend t'i drejtohet jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit, sipas së cilës: *në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur³². Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon vetëm detyrimin e subjektit dhe personit tjetër të lidhur për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë prej personit tjetër të lidhur. Në këtë kuptim, verifikimi i ligjshmërisë së krijimit duhet të ndalet deri te burimi i krijimit të saj, që është mënyra se si personi tjetër i lidhur e ka krijuar atë. [...] Për pasojë, në këtë kuptim, subjekti është i zhveshur në kuptim të këtij ligji nga ndonjë detyrim i cili do të kondiciononte ligjshmërinë e pasurisë përtej provimit të krijimit të saj prej personit të lidhur nga burime të ligjshme e të verifikueshme³³.*
54. Nën dritën e kësaj jurisprudence, si dhe në vijim të arsyetimit të mësipërm, trupi gjykues vlerësoi se verifikimi i ligjshmërisë së shumës prej 15.000 eurosh, duhet të limitohet deri në verifikimin e veprimeve të kryera nga prindërit e subjektit të rivlerësimit për të krijuar këtë shumë. Në këtë linjë arsyetimi, trupi gjykues vëren se në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.04.2011, z. B. D. dhe znj. I. D. kanë shpjeguar dhe burimin e shumës prej 15.000 eurosh, e cila rrjedh nga diferenca mes vlerës së shitjes së një apartamenti me sipërfaqe 130 m² në Durrës, z. Xh. B., më datë 04.12.2006, për çmimin prej 9.000.000 lekësh dhe vlerës së blerjes prej tyre të një apartamenti prej 5.300.000 lekësh, më datë 15.12.2006. Kryerja e transaksionit të shitjes së pasurisë së apartamentit me sipërfaqe 130 m², kundrejt çmimit prej 9.000.000 lekësh më datë 04.12.2006, provohet nga kontrata e shitjes me kusht nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.12.2006, e lidhur mes z. B. D. në cilësinë e shitësit dhe z. Xh. B. në cilësinë e blerësit, sipas së cilës z. D. e ka përfituar të gjithë vlerën e shitjes së pasurisë përpara datës së lidhjes së kontratës. Sipas kontratës së shitjes me kusht nr. {***} prot., datë 15.12.2006, e lidhur në zyrën e shoqërisë “{***}” ShPK Durrës, mes shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShPK, në cilësinë e shitësit, dhe z. B. D., në cilësinë e blerësit dhe sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.10.2016, lëshuar nga palët kontraktore të sipërcituara, rezulton se z. B. D. ka blerë një apartament, në vlerën 5.300.000 lekë, e likuiduar tërësisht. Nga të dhënat e kësaj situatë faktike, trupi gjykues arriti në konkluzionin se efektivisht, shuma prej 15.000 eurosh buron nga një likuiditet i krijuar si pasojë e transaksionit të ligjshëm, që është kontrata e shitjes me kusht të pasurisë së paluajtshme apartament nr. {***} rep., nr. {***} kol.,

³² Paragrafi 110 i vendimit nr. 10/2019 (JR) të Kolegjit.

³³ Vendimi nr. 15/2021 (JR), datë 18.06.2021, paragrafi 23.14.

datë 04.12.2006, e lidhur mes z. B. D., në cilësinë e shitësit, dhe z. Xh. B., në cilësinë e blerësit, e cila është një veprim juridik i vlefshëm, pasi plotëson të gjitha kushtet e parashikuara në nenin 663 të Kodit Civil dhe konkretisht: (i) pëlqimi i palëve; (ii) shkaku i ligjshëm; (iii) objekti i kontratës të jetë i përcaktuar dhe i ligjshëm; (iv) forma e kërkuar ligjore.

55. Në verifikim të pagimit të detyrimeve tatimore, në kohën e kryerjes së këtij transaksioni, nga përmbajtja e kontratës së sipërcituar, rezulton se palët në të kanë rënë dakord se ky apartament, për efekt procedure, nuk është regjistruar në ZVRPP Durrës, pasi nuk është realizuar regjistrimi fillestar nga shoqëria ndërtimore, prandaj për këtë shkak nuk mund të realizohej kontrata e shitblerjes dhe midis palëve lidhej kontrata e shitjes me kusht. Blerësi, z. Xh. B., ka qenë dakord për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 130 m², me kushtin që kur të bëhej regjistrimi në ZVRPP Durrës, do të realizohej dhe kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie.

Nga dokumentet e administruara, rezulton se sipas kontratës së shitjes me kusht nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.08.2003, të lidhur mes shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShPK, në cilësinë e shitësit, dhe z. B. D., në cilësinë e blerësit, kjo shoqëri i shet shtetasit B. D. një apartament me sipërfaqe 130 m² [apartamenti që z. B. D. i ka shitur z. Xh. B.], për çmimin prej 48.000 USD³⁴. Me regjistrimin në ZVRPP Durrës të ndërtimit të realizuar nga shoqëria “{***}” ShPK, z. B. D. i lindte e drejta e realizimit të kontratës së shitblerjes dhe regjistrimit në zyrën e regjistrimit të pasurive Durrës të pasurisë objekt kontrate.

Nga informacioni i përcjellë në Komision nga ZVRPP Durrës me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 20.03.2019, rezultoi se z. B. D. nuk kishte të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme asnjë nga pasuritë për të cilat ka lidhur kontratat e mësipërme të shitblerjes.

Në vështrim të këtyre fakteve, trupi gjykues konstatoi se kontrata e lidhur mes z. B. D. dhe z. Xh. B. nuk është një kontratë me anë të së cilës kalohen të drejta reale, por që synon të kalojë të drejtat e pronësisë, me kushtin që kjo do të ndodhë sapo të sigurohet pajisja e z. D. me dokumentacionin që certifikon këtë të drejtë të tij.

Nga kryerja e këtij veprimi juridik, z. B. D. ka realizuar një fitim që konsiston në diferencën mes çmimit të paguar për blerjen/porositjen e këtij apartamenti dhe shitjes së tij, për të cilin duhej të paguante detyrimin tatimor, sipas parashikimit të nenit 8, pika 1, shkronja “dh” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

56. Gjatë gjykimit në Kolegj, por edhe në përgjigje të barrës së provës së kaluar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *menjëherë pas shitjes së apartamentit me sipërfaqe 130 m², im atë është interesuar në ish-ZVRPP Durrës, duke e njohur atë si detyrim të shitësit pagimin e tatimit mbi fitimin për kalimin e pronësisë, por prej tyre ka marrë përgjigjen se ende nuk i ka lindur ai detyrim, për aq kohë sa pasuria objekt shitjeje nuk është regjistruar në ZVRPP Durrës. Me lindjen e së drejtës për të paguar tatimin mbi fitimin, pra me regjistrimin e pronës (apartamentit) të shitur, detyrimi do të shlyhet sipas ligjit dhe akteve normative në fuqi.*

Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shkresën e DVASHK Durrës nr. {***} prot., datë 06.05.2020, me lëndë “Kthim përgjigjeje”, drejtuar znj. Etleva Deda, sipas përmbajtjes të së cilës *tatimi mbi fitimin e kalimit të pronësisë si një detyrim që buron nga udhëzimi nr. 29, datë 30.07.2018, paguhet prej shitësit për pasuritë e paluajtshme, të cilat janë të regjistruara në regjistrat e pasurive të*

³⁴ Sipas përmbajtjes së deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.05.2020, të administratorit të vetëm dhe ortakut të shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShPK, shtetasit F. F., shtetasi B. D., në lidhje me apartamentin 3+1, me sip. 130 m², ka likuiduar totalisht shumën prej 48.000 USD, ku 24.000 USD i ka paguar në datën 20.08.2003, kur është lidhur “Kontratë shitje me kusht” nr. {***} rep., nr. {***} kol., dhe këstin e dytë të çmimit të apartamentit e ka paguar në fund të vitit 2004, duke respektuar afatin 2-vjeçar, parashikuar në kontratë.

paluajtshme, ndërsa për pasuritë e paregjistruara, ky tatim paguhet në momentin e regjistrimit të aktit të kalimit të së drejtës së pronësisë së paluajtshme pranë ZVRPP-së, sot DVASHK-ja.

Të njëjtën përgjigje, DVASHK Durrës i ka kthyer subjektit të rivlerësimit edhe në vërtetimin nr. {***}, datë 07.06.2022, drejtuar znj. Etleva Deda, akt i cili është paraqitur prej saj në cilësinë e provës, me qëllim paraqitjen e situatës aktuale të regjistrimit të pronës objekt shqyrtimi, në kohën e gjykimit të çështjes në Kolegj. DVASHK Durrës ka vërtetuar se apartamenti me sipërfaqe 130 m², ndërtuar nga shoqëria “{***}” ShPK, e cila ka ndryshuar emër në “{***}” ShPK, nuk figuron i regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, as në emër të shoqërisë së ndërtimit, as në emër të z. B. D., si dhe as në emër të z. Xh. B. apo trashëgimtarëve të tij.

57. Në analizë të këtyre rrethanave faktike, në raport me legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues vëren se udhëzimi i përbashkët nr. 29, datë 30.7.2018, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme”, i ministrit të Financave dhe ministrit të Drejtësisë³⁵, në mënyrë të përmbledhur parashikon se: *tatimi mbi fitimin e kalimit të pronësisë për pasuritë e paluajtshme të paregjistruara, paguhet në momentin e regjistrimit të aktit të kalimit të së drejtës së pronësisë së paluajtshme pranë ZVRPP-së, sot DVASHK-ja.* Sipas këtij udhëzimi, me “kalim të së drejtës së pronësisë”, kuptohet akti i shitjes, dhurimit apo heqjes dorë nga pasuria e paluajtshme dhe me termin “fitim kapital i realizuar”, kuptohet diferenca pozitive ndërmjet vlerës në shitje dhe vlerës në blerje të pasurisë së paluajtshme.
58. Pavarësisht këtyre parashikimeve, duke qenë se ka kaluar një kohë e gjatë nga momenti i shitjes së pasurisë objekt shqyrtimi deri në gjykimin e çështjes në Kolegj, trupi gjykues vlerësoi të nevojshme t’u drejtohet edhe parashikimeve ligjore në kohën e lidhjes së kontratës së shitjes me kusht të pasurisë së paluajtshme, apartament me sipërfaqe 130 m², nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.12.2006, e lidhur mes z. B. D., në cilësinë e shitësit, dhe z. Xh. B., në cilësinë e blerësit, kohë kur z. D. ka realizuar fitimin nga diferenca mes çmimit të blerjes dhe çmimit të shitjes së pasurisë së paluajtshme. Sipas legjislacionit tatimor të kohës, dhe konkretisht sipas parashikimit të nenit 11 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, sipas formulimit që ky nen ka pasur në dhjetor të vitit 2006³⁶, tatimi për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme derdhej pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme nga personi që kalonte të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit të pasurisë. Edhe udhëzimi nr. 5, datë 31.01.2005, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ministrit të Financave, parashikonte në pikën 2.7.3 të tij, se: “Tatimi mbi të ardhurat nga kalimi i të drejtës së pronësisë paguhet nga individi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme. Derdhja bëhet para kryerjes së regjistrimit të sendeve të mësipërme, në përputhje me aktet ligjore. Zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme mbledhin tatimin lidhur me kalimin e të drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme dhe e derdhin atë brenda 10 ditëve nga kryerja e veprimeve në llogarinë e administratës tatimore”.

³⁵ Udhëzim i zëvendësuar me udhëzimin e përbashkët nr. 15/1, datë 25.11.2021, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 192, datë 14.12.2021, të ministrit të Financave dhe drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

³⁶ Neni 11 i ligjit nr. 8438/1998, i ndryshuar me ligjin nr. nr. 9326, datë 6.12.2004, parashikonte se:

“1. Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme tatóhet sipas pasqyrës nr. {***}, e cila i bashkëlidhet këtij ligji, ndërsa pasuritë e paluajtshme, tokë bujqësore, tatóhen në masën 0,5 për qind të çmimit të shitjes.

2. Tatimi derdhet nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit të sendeve të mësipërme, në përputhje me aktet ligjore. Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet, pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

3. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme janë të detyruara që, brenda 10 ditëve, të derdhin tatimin e paguar sipas parashikimeve të këtij neni”.

Bazuar në analizën e mësipërme të kuadrit ligjor, trupi gjykues vlerësoi se babait të subjektit të rivlerësimit, detyrimi për të paguar detyrimin tatimor, do t'i lindte në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes dhe regjistrimit të pasurisë në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Në kushtet kur kontrata e shitblerjes nuk është lidhur ende, siç rezultoi nga hetimi i kryer në Kolegj, nuk ka lindur ende detyrimi i z. D. për të paguar detyrimin tatimor.

59. Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se plotësohen kërkesat e nenit 32, pika 4 për garantimin e ligjshmërisë së krijimit të shumës prej 15.000 eurosh, e cila i është dhuruar subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Deda, nga prindërit e saj, duke e konsideruar shumën e dhuruar si burim të ligjshëm për krijimin e pasurisë, apartament në Tiranë, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
60. Pavarësisht përfundimit të arritur më sipër, me qëllim analizimin shterues të të gjitha shkaqeve ankimore të Komisionerit Publik, trupi gjykues shqyrtoi edhe pretendimin e tij se, bazuar në përlllogaritjet përkatëse, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur/të tjerë të lidhur rezultojnë me mungesë të të ardhurave të ligjshme në shumën totale prej 12.332 USD, për të blerë pasurinë, apartament me sipërfaqe 130 m², në Durrës, me çmim blerje 48.000 USD, pasuri e cila ka shërbyer si burim për krijimin e shumës së dhuruar prej 15.000 eurosh, për blerjen e apartamentit në Tiranë, në pronësi të subjektit të rivlerësimit.
61. Në analizë të këtij pretendimi të Komisionerit Publik, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet gjatë gjykimit në Kolegj, si edhe në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit në Komision, ka pretenduar se vlerësimi i Komisionerit Publik nuk është i bazuar, pasi prindërit e saj kanë pasur burime të mjaftueshme financiare për të blerë pasurinë, apartament me sipërfaqe 130 m², në Durrës.
- Në argumentet e saj, subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, si burime financiare për krijimin e kësaj pasurie ka specifikuar:
- i. të ardhurat nga pagat e saj si zëvendësgjyqtare dhe gjyqtare deri në fund të vitit 2004;
 - ii. të ardhurat e prindërve të saj nga aktiviteti tregtar i kryer në periudhat 2002-2004 dhe 1994-2002;
 - iii. të ardhurat e motrës së saj, znj. A. D., nga pagat si mësuese, për periudhën janar 1994-gusht 2000.
62. Trupi gjykues vëren se, sipas kontratës së shitjes me kusht nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.08.2003, të lidhur mes shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShPK, në cilësinë e shitësit, dhe z. B. D., në cilësinë e blerësit, shoqëria “{***}” ShPK i ka shitur z. B. D. një apartament me sipërfaqe 130 m², në Durrës, për çmimin prej 48.000 USD. Kësti i parë, në vlerën prej 24.000 USD, është likuiduar në dorë, në zyrën e noterisë Durrës, në praninë e noterit, ndërsa kësti i dytë, në shumën prej 24.000 USD, do të likuidohet gjatë periudhës dyvjeçare deri në dorëzimin e çelësave në dorë. Referuar deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.05.2020, të administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK³⁷, z. B. D., ka likuiduar totalisht shumën prej 48.000 USD, në dy këste: 24.000 USD i ka paguar në datën 20.08.2003, në datën e lidhjes së kontratës së shitjes me kusht, dhe pjesën e mbetur e ka paguar në fund të vitit 2004, duke respektuar afatin 2-vjeçar të parashikuar në kontratë.
63. Bazuar në këto rrethana faktike, analiza financiare për verifikimin e mundësisë së prindërve të subjektit të rivlerësimit për të kryer pagesën e shumës 48.000 USD, u krye e ndarë për dy periudhat

³⁷ Shoqëria “{***}” ShPK, me ortak dhe administrator, z. F. F. dhe z. Q. K., është çregjistruar dhe është krijuar shoqëria “{***}” ShPK me administrator dhe ortak të vetëm, z. F. F. (për shkak se ortaku, z. Q. K., ndërroi jetë).

01.01.1994 - 20.08.2003 dhe 21.08.2003 - 31.12.2004, në të cilat ka rezultuar pagesa e kësteve përbërëse të shumës së sipërcituar, secili prej tyre në vlerën 24.000 USD.

63.1 Në analizën financiare, në zërin e të ardhurave, u përlogaritën të ardhurat *neto* të subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Deda, nga paga e përfiturat si zëvendësgjyqtare dhe gjyqtare, në mbështetje të informacionit të përcjellë në vërtetimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë; të ardhurat e znj. A. D. nga pagat *neto* si mësuese, sipas vërtetimit për bazën e vlerësueshme, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës.

63.2 Për sa u përket të ardhurave të prindërve të subjektit të rivlerësimit, nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi se znj. I. D. ka ushtruar aktivitet tregtar, biznes i vogël, “Tregtim artikujsh të ndryshëm industrialë”, për periudhën 1994 -2002. Sipas shkresës nr. {***} prot., datë 14.11.2016, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, tatimpaguese I. D., me kod fiskal {***}, ka realizuar të ardhura bruto, për periudhën 1994 - maj 2002, në vlerën 6.162.810 lekë.

Z. B. D. ka ushtruar aktivitet tregtar, biznes i vogël, “Tregtim artikujsh të ndryshëm industrialë”, për periudhën 2002-2008. Sipas shkresës nr. {***} prot., datë 17.11.2016, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, nëpërmjet së cilës jepen të dhëna mbi aktivitetin tregtar të tatimpaguesit B. D., vlera totale e të ardhurave bruto të realizuara prej tij, për periudhën 2002-2004, është në vlerën 3.168.000 lekë.

Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, rezulton se z. B. D. ka ushtruar aktivitet tregtar edhe në vitet 2016, 2017 dhe 2018, dhe sipas deklaratave tatimore të këtyre viteve, norma mesatare e fitimit të realizuar prej tij në këto tri vite, është rreth 34,45% e qarkullimit.

Në kushtet kur aktiviteti tregtar i kryer nga prindërit e subjektit të rivlerësimit dhe pagimi prej tyre i detyrimeve tatimore, referon për realizim të të ardhurave të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, fakt ky i pranuar edhe nga Komisioneri Publik në ankim, trupi gjykues, në mungesë të të dhënave për fitimin e realizuar për periudhat e marra në analizë, vlerësoi të përlogarisë këtë fitim, duke marrë si bazë krahasimore normën mesatare të fitimit për vitet 2016, 2017, 2018, siç është referuar më sipër. Shtrirja e normës mesatare të fitimit si më sipër cituar, edhe për periudhën 1994-2004, nuk do të ishte reale duke pasur në konsideratë llojin e aktivitetit tregtar të kryer nga prindërit e subjektit, kërkesën e lartë të tregut për këto produkte gjatë kësaj periudhe, si dhe faktorin kohë, të cilët ndikojnë situatën ekonomiko-sociale si indikator për normën e fitimit. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se norma mesatare e fitimit është me 40% për vitet 2001-2004 dhe me 50% për vitet 1994-2000.

63.3 Në zërin e shpenzimeve janë përlogaritur shpenzimet e jetesës sipas jurisprudencës së Kolegjit në masën 66% të të ardhurave të realizuara nga personat e lidhur dhe në masën 30% të të ardhurave të realizuara nga subjekti i rivlerësimit për periudhën 1994-1999 dhe, sipas standardit të ILDKPKI-së, bazuar në INSTAT për periudhën 2000-2004, sipas përbërjes familjare të subjektit të rivlerësimit në këto vite. Në zërin e shpenzimeve janë përlogaritur edhe shpenzime të tjera të evidentuara nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, si dhe shumat e paguara për këstet respektive të blerjes së pasurisë, apartament me sipërfaqe 130 m², në

shumën 24.000 USD ose 2.862.480 lekë³⁸ për pagesën e kështit e parë në datën 20.08.2004 dhe në shumën 24.000 USD ose 2.269.920 lekë³⁹ për pagesën e kështit të dytë në fund të vitit 2004.

Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, sipas të dhënave të evidentuara më sipër, rezultoi se prindërit e subjektit të rivlerësimit dispononin të ardhura të ligjshme për të paguar kështet për blerjen e pasurisë, apartament me sipërfaqe 130 m², në Durrës.

64. Trupi gjykues arriti në konkluzionin se qëllimi kushtetues i parashikuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës për verifikimin e ligjshmërisë së shumës së dhuruar subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Deda, nga prindërit e saj, është përmbushur, pasi rezultoi se prindërit e subjektit të rivlerësimit kishin burime financiare të ligjshme për të realizuar këtë dhurim.
65. Në përfundim të shqyrtimit të shkakut të ankimit të Komisionerit Publik për pamjaftueshmërinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të kryer pagesën e kështit në vitin 2009, për blerjen e pasurisë, apartament banimi me sipërfaqe 115 m², në Tiranë, trupi gjykues, pasi analizoi në harmoni deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe në deklaratimet periodike të interesave, shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe provat e administruara, lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, të kontestuara nga Komisioneri Publik, në përmbledhje të arsyetimit të shtjelluar më sipër në këtë vendim, arriti në konkluzionet si vijojnë.

65.1 Lidhur me burimin e deklaruar, të ardhura nga kredia e disbursuar më datë 25.09.2006, në shumën 5.000.000 lekë, trupi gjykues, në kuptim të parashikimit të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, krijoi bindjen e bazuar në prova se subjekti i rivlerësimit ka pasur të disponueshme këtë shumë, në *cash*, në momentin e pagesës së kështit të parë të apartamentit në Tiranë.

65.2 Lidhur me burimin e deklaruar, të ardhura nga paga, përdorur për pagesën e kështit të parë të pasurisë së sipërcituar, analiza financiare e kryer në Kolegj, tregoi se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi që të krijonte kursimet në *cash* të deklaruara në këto vite e, për rrjedhojë, t'i përdorte ato për pagesën e kështit të pasurisë objekt kontrolli.

65.3 Lidhur me burimin e deklaruar, dhurim nga prindërit në shumën 15.000 euro, trupi gjykues vlerësoi se kjo shumë ka buruar nga një transaksion i ligjshëm i kryer nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, duke plotësuar kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

66. Në konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit kishte burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për krijimin e pasurisë, apartament me sipërfaqe 115 m², në Tiranë, për pasojë pretendimi i Komisionerit Publik për të kundërtën, u gjend i pabazuar.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë

67. Komisioneri Publik ka pretenduar në ankim se *subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi edhe në kushtet kur eventualisht justifikon në kuptimin formal kriteret e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për marrjen e kredisë me kushte lehtësuese, mbetet i pajustificuar dhe i padrejtë në vlerësimin e etikës*

³⁸ Llogaritur sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, për periudhën 01.01.2003 - 20.08.2003, sipas të cilit 1 USD = 119,92 lekë.

³⁹ Llogaritur sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, të vitit 2004, sipas të cilit 1 USD = 94,58 lekë.

së subjektit të rivlerësimit, fakti që ka përdorur vlerën e saj për të përfituar nga konvertimi i monedhave për periudhën në fjalë, përfitime të cilat nuk i ka dokumentuar dhe deklaruar në asnjë nga deklaratat periodike vjetore. Në vështrimin e Komisionerit Publik, veprimet e mësipërme, të padokumentuara dhe të padokumentuara, të kryera nga subjekti i rivlerësimit me qëllim krijimin e të ardhurave shitesë, duke përdorur shumën e përfituar si kredi me kushte lehtësuese, janë në kontradiktë me sjelljen që pritet nga një magjistrat dhe cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

68. Në analizë të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues vëren se Komisioneri Publik ka arritur në konkluzionin e mësipërcituar, bazuar në konstatimet e Komisionit në rezultatet e hetimit administrativ se për pagesën e kështit të parë të pasurisë, apartament me sipërfaqe 115 m², në Tiranë, në shumën 72.000 euro, subjekti rezultonte me një balancë negative në vlerën -518.690 lekë. Në lidhje me këtë diferencë negative, Komisioni ka konstatuar se *vërehet një luhajtje e madhe e kursit të këmbimit në periudhën 2007 - 2009 (nga 121 lekë në 137 lekë sipas Bankës së Shqipërisë), e cila mund të ketë impakt në rezultatin negativ, duke qenë se nuk dihet kur është kryer këmbimi i vlerës së kredisë dhe me çfarë kursi këmbimi.*
69. Në kundërshtim të konkluzionit të mësipërm të Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar në parashtrimet e tij në Kolegj, se u qëndron shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit, në të cilat ka deklaruar se: *[...] në lidhje me diferencën negative të konstatuar, ju bëj me dije se edhe unë, sikurse shumica e popullsisë, këmbimin e lekut në euro e kam kryer në momentet më të volitshme, duke ndjekur kursin e këmbimit. Si shumën e kredisë, edhe të ardhurat nga shitja e dyqanit në datën 24.12.2007, ashtu edhe kursimet nga paga ndër vite, i kam konvertuar nga lekë në euro në kohë të ndryshme, duke ndjekur kursin e këmbimit në favor të euros. Aktualisht nuk mund të përcaktoj se me sa i kam këmbyer (kjo pasi jo vetëm që është kohë e largët, por edhe se është veprim i kryer në shumën të ndryshme në kohë të ndryshme). Referuar konstatimit tuaj, ku është vërejtur një luhajtje e madhe e kursit të këmbimit në periudhën 2007 – 2009 (nga 121 në 137 sipas Bankës së Shqipërisë), nëse totali i burimeve në lekë, në vlerën 7.300.000 lekë, do të konvertohej me 121 lekë/euro, rezulton se totali i burimeve të konvertuara është në vlerën 60.330 euro dhe duke i shtuar edhe vlerën prej 15.000 euro (dhuratë e prindërve), totali i vlerës së burimeve për kështin e parë të pagesës së apartamentit shkon në 75.330 euro, pra, 3.330 euro më shumë. Deklaroj me përgjegjësi të plotë se shumën e zotëruar prej meje nga burimet e deklaruara e të sipërshënuara, në datën 09.10.2009, ka qenë në vlerën 72.000 euro, nga të cilat 57.000 euro janë përfituar nga konvertimi i lekëve në euro. Burimet e deklaruara nga ana ime kanë qenë të mjaftueshme për pagesën e këtij kështi.*
70. Në analizë të shkakut të ankimit, trupi gjykues vëren se cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, Komisioneri Publik e ka perceptuar si rrjedhojë e veprimeve të subjektit të rivlerësimit në kontradiktë me sjelljen që pritet nga një magjistrat, veprime të padrejta dhe të pajustificuara në vlerësim të etikës, bazuar në rrethanën e përdorimit të shumës së përfituar nga kredia në kushte lehtësuese për të përfituar nga konvertimi i monedhave për periudhën 2007-2008 dhe mosdeklarimit të këtij përfitimi në asnjë nga deklaratat periodike vjetore.
71. Në analizë të rrethanave të pretenduara nga Komisioneri Publik, nga shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në Komision gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, ka qenë në kërkim të blerjes së një banese që nga momenti i marrjes së kredisë dhe ka vlerësuar se do të ishte më e përshtatshme që të blinte një banesë jo në Durrës ku ajo banonte, por në Tiranë – në vendin ku ushtronte detyrën e gjyqtarës, ku tregu i shitblerjes

së banesave funksiononte në monedha të ndryshme, kryesisht në valutë të huaj⁴⁰. Në këto kushte, trupi gjykues çmon të logjikshëm shpjegimin e subjektit të rivlerësimit se *si shumë e kredisë, edhe të ardhurat nga shitja e dyqanit në datën 24.12.2007, ashtu edhe kursimet nga paga ndër vite, i kam konvertuar nga lekë në euro në kohë të ndryshme, duke ndjekur kursin e këmbimit në favor të euros*. Edhe çmimi për të cilin kanë rënë dakord palët në kontratën e porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.10.2009, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 115 m² në Tiranë, i përcaktuar në monedhën euro, justifikon veprimet e subjektit të rivlerësimit për këmbimin në monedhën euro të shumës së parave që dispononte *cash* në lekë, përfshirë edhe shumë e përfituar nga kredia me kushte lehtësuese.

72. Këmbimi valutor është një veprimtari e ligjshme⁴¹, e cila nënkupton shndërrimin e një monedhe në një monedhë tjetër⁴². Sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Deda, ajo ka kryer pikërisht këtë veprim, ka këmbyer paratë nga një monedhë në tjetrën, me qëllim krijimin e një gjendjeje/shume monetare në monedhën euro, për blerjen e një banese, qëllim ky edhe i marrjes së kredisë në kushte lehtësuese. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, ka deklaruar se veprimi i këmbimit të monedhave është kryer vetëm në një kah, nga lekë në euro, si dhe se ka qenë një *veprim i kryer në shumën të ndryshme në kohë të ndryshme*, vlera e kredisë nga monedha “lekë” është transformuar në monedhën “euro”, por duke e kryer këmbimin nga lekë në euro në kursin më të favorshëm në periudha të ndryshme, duke arritur shumë e synuar në monedhën “euro”, pra subjekti i rivlerësimit dispononte likuiditete *cash* në të njëjtën vlerë, por në monedhë tjetër. Përfitimi i mundshëm financiar nga ky veprim, do të mund të identifikohet vetëm nëse subjekti i rivlerësimit këtë shumë do ta kishte investuar në institucione bankare për të përfituar mbi këtë shumë nga normat e interesit, apo nëse do ta kishte këmbyer këtë shumë nga “lekë” në “euro” dhe anasjellas, duke kryer kështu veprime financiare të përafërta me një agjent këmbimi valutor. Nuk mund të lihet pa vënë re në këtë arsyetim se, duke kryer veprimin e këmbimit nga lekë në euro – vetëm në një kah – qëllimi i subjektit të rivlerësimit nuk duket të ketë qenë përfitimi i pastër nga një transaksion financiar, por duke qenë se çmimi i blerjes së banesës me probabilitet më të lartë do të ishte në “euro”, të paktën do të ruante të pandryshuar vlerën e kredisë në momentin e përdorimit të saj.
73. Në vijim të këtij arsyetimi, trupi gjykues vlerëson me rëndësi nënvizimin e faktit se subjekti i rivlerësimit, duke konvertuar shumë e kredisë nga “lekë” në “euro”, për të paguar çmimin e pasurisë së përcaktuar në euro, nuk mund të konsiderohet se ka përdorur shumë e marrë kredi në kundërshtim me qëllimin e parashikuar në kontratën e kredisë bankare, as se e ka investuar atë në kundërshtim me këtë qëllim, e aq më tepër që të ketë përfituar nga fonde publike nga investimi i kësaj shume, veprime këto të cilat mund të përbënin premisa për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, në shkelje të etikës së magjistratit⁴³. Në konkluzionin e tij se subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, Komisioneri Publik i ka dhënë peshë vetëm një deklarami të saj në komunikimet elektronike me ILDKPKI-në, në *e-mail*-in e dërguar punonjësit përgjegjës të këtij

⁴⁰ Fakt ky i njohur edhe nga pasqyrimi i situatave faktike për subjekte të ndryshme rivlerësimi në jurisprudencën e Kolegjit, sipas të cilave vlera e shitjes apo blerjes së banesave, ka qenë kryesisht në valutë të huaj.

⁴¹ Banka e Shqipërisë, në zbatim të nenit 61 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka miratuar me vendimin nr. 31, datë 06.06.2007, rregulloren “Për licencimin, organizmin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor”.

⁴² Sipas nenit 3, shkronja “i” e rregullores së sipërcituar, “‘kursi këmbimi’ është çmimi relativ i një monedhe të shprehur në njësi të një monedhe tjetër, në një datë të caktuar”.

⁴³ Vendimi i Kolegjit nr. 13/2021, datë 10.06.2021, paragrafi 128.

institucioni më datë 24.09.2010, të administruar nga Komisioni, lidhur me pagesën e këstit të parë të pasurisë apartament në Tiranë, në të cilat, ndër të tjera, ka parashtruar se *në këstin e parë përfshihet kredia e marrë për këtë qëllim në vitin 2006, e cila është konvertuar nga lekë në euro dhe anasjelltas, në varësi të kursit të këmbimit valutor, duke qenë se e disponoja në "cash"*.

74. Megjithëse çmoi se në arritjen e një konkluzioni lidhur me pretendimin e ngritur nga Komisioneri Publik, do të duhet të merren në analizë të gjitha të dhënat e rezultuara dhe provuara, pjesë përbërëse e të cilave janë dhe shpjegimet e deklaratimit të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, të cilave vetë ligji nr. 84/2016, në nenin 49, pika 2 u ka dhënë vlerën e provës në këtë proces, trupi gjykues shqyrtoi pretendimin e Komisionerit Publik se nga konvertimi i shumës së marrë nga kredia me kushte lehtësuese, nga monedha lekë në euro dhe anasjelltas, subjekti i rivlerësimit ka gjeneruar të ardhura shtesë të cilat nuk janë deklaruar e, për pasojë, ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues, shumë prej 5.000.000 lekësh, të disponuar në *cash* nga subjekti i rivlerësimit, si rezultat i tërheqjes së kredisë bankare, e konvertoi nga lekë në euro dhe anasjelltas, duke ndjekur kursin më të favorshëm, nga data 30.04.2007, kur kjo shumë është tërhequr nga Banka ProCredit, deri në datën 09.10.2009, data e kryerjes së pagesës së këstit të parë për pasurinë apartament në Tiranë. Nga ky test, rezultoi se të ardhurat shtesë të përfituara nga subjekti i rivlerësimit do të ishin në shumën 59.584 lekë. Trupi gjykues çmoi të nënvizojë se ky testim i përket një periudhe dyvjeçare, duke përdorur luhatjet e kursit të këmbimit në vlerat mesatare më të favorshme, sipas treguesve të tij nga të dhënat e Bankës së Shqipërisë, për blerjen e 1 euro me 126,49 lekë dhe për shitjen e 1 euro për 128 lekë. Në këto kushte, vlerat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit, nëse do të kishte kryer konvertim të shumës prej 5.000.000 lekësh në dy kahe, do të ishin të papërfillshme, jo vetëm në kuptim të peshës së të ardhurave të përfituara, por edhe në kuptim të rëndësisë së tyre për t'i vlerësuar si deklarim i pasaktë i subjektit të rivlerësimit, për shkak të mungesës së deklaratimit të tyre në deklaratimet periodike vjetore të interesave privatë.
75. Në vijim të këtij arsyetimi, trupi gjykues, në mbështetje edhe të jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit⁴⁴, sipas së cilës *ka një sërë sjelljesh nëpërmjet të cilave subjektet e rivlerësimit minojnë integritetin e institucioneve të drejtësisë dhe cenojnë besimin e publikut në sistemin tonë të drejtësisë, përmes korrupsionit, marrëdhënieve të rreme, shkeljes së betimit si nëpunës publik, veprimtari në situatën e konfliktit të interesit, paaftësisë në punën profesionale, vendosjes së interesave privatë përpara interesit publik etj.*, vlerësoi se këmbimi i shumës së përfituar nga kredia bankare në kushte lehtësuese, nga monedha lekë në euro, me qëllim blerjen e pasurisë apartament, në përmbushje të destinacionit të kredisë, por edhe të detyrimit kontraktor për pagesën e çmimit në monedhë të huaj, edhe pse hipotetikiisht mund të kishte gjeneruar të ardhura shtesë, nuk mund të përbëjë një shkelje etike apo sjellje që cenon parime dhe standarde të pranuar të etikës së magistratit, të përcaktuara këto në Kodin e Etikës së Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, i cili në rregullin 15 përcakton: *Gjyqtari duhet të kryejë të gjitha veprimtaritë jashtëgjyqësore në mënyrë të tillë që ato të mos hedhin dyshime të arsyeshme për paanësinë e tij, të ulin autoritetin e pushtetit gjyqësor ose të ndërhyjnë në kryerjen e detyrave gjyqësore*, ndërsa në rregullin 19: *Gjyqtari nuk duhet të lejojë që marrëdhëniet familjare, sociale, politike apo marrëdhënie të tjera, të ndikojnë në sjelljen gjyqësore të gjyqtarit ose në gjykim. Gjyqtari nuk duhet as ta përdorë autoritetin e të qenit gjyqtar për të arritur, përmbushur interesat e tij ose të të*

⁴⁴ Vendim nr. 10/2021 (JR), datë 24.03.2021, subjekti i rivlerësimit A. P..

tjerëve dhe as nuk duhet të krijojë ose të lejojë të tjerët të krijojnë përshtypjen se ata gjenden në një pozitë të veçantë për të ndikuar mbi gjyqtarin⁴⁵.

76. Trupi gjykues vlerësoi se rrethanat mbi të cilat Komisioneri Publik ka mbështetur konkluzionin e tij, nuk justifikojnë aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i cili passjell shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, pasi nga analiza e të gjitha fakteve të rezultuara e të provuara, nuk u evidentuan shkaqe e shkelje konkrete që të çonin në bindjen se cenimi i besimit të publikut ishte i perceptueshëm dhe real, të cilat të meritonin trajtimin dhe analizën në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
77. Pavarësisht analizës e arsytimit si më sipër, bazuar edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit⁴⁶, trupi gjykues sjell në vëmendje se aplikimi i pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 duhet të mbështetet në vlerësimin tërësor të tri kriterëve të rivlerësimit apo në vlerësimin e përgjithshëm të procedurave të rivlerësimit në raport me sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë këtij procesi e jo duke analizuar e evidentuar rrethana të caktuara, në mënyrë të veçantë, vetëm për njërin prej kriterëve të rivlerësimit, në rastin konkret vetëm kriterin e vlerësimit të pasurisë të subjektit të rivlerësimit.
78. Në konkluzion, trupi gjykues nuk evidentoi rrethana që duhen konsideruar sipas nenit 4, pika 2 dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 e, për pasojë, arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.
79. Në përfundim të sa më sipër, pas shqyrtimit të të gjitha shkaqeve të ankimit, trupi gjykues arriti në konkluzionin se vlerësimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit lidhur me kriterin e pasurisë, është i drejtë dhe i bazuar në fakte dhe në ligj. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, vlerësohet se ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së saj dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
80. Për vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit, sipas vendimit të Komisionit, ka rezultuar se ka një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.
81. Trupi gjykues, në vijim të konkluzioneve të mësipërme, bazuar në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, vlerësoi se vendimi nr. 256, datë 12.06.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, është i bazuar në fakte dhe në ligj e, për pasojë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

⁴⁵ Kodi i Etikës Gjyqësore, 2006: http://www.gjykataelarte.gov.al/web/kodi_i_etikes_gjyqesore_1754.pdf.

⁴⁶ Vendimi nr. 33/2021, datë 03.11.2021; vendimi nr. 15, datë 18.06.2021.

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 256, datë 12.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Deda.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 21.07.2022.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi - kundër

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

Unë, anëtari i trupit gjykues, Sokol Çomo, në ndryshim nga shumica e trupit gjykues në përfundim të shqyrtimit të çështjes, kam votuar për ndryshimin e vendimit nr. 256, datë 12.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Deda, dhe shkarkimin e saj nga detyra.

Ky qëndrim është bazuar në vlerësimin tim se subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë për arsyet e mëposhtme.

1. Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik se, *për burimin e krijimit “të ardhura nga kredia”, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit se është përdorur për pasurinë, apartament në Tiranë, subjekti i rivlerësimit, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm*, konstatova sa më poshtë.
2. Me kontratën e kredisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.09.2006, të lidhur me Raiffeisen Bank, subjekti i rivlerësimit ka përfituar një kredi në shumën 5.000.000 lekë. Sipas përmbajtjes së kësaj kontrate, qëllimi i dhënies së kredisë ishte përdorimi i saj *për blerje apartamenti*. Kredia akordohej për një afat 168 muaj dhe afati fillonte që nga dita e disbursimit të parë. Nga norma e interesit të aplikuar, prej 12%, kredimarrësi, subjekti i rivlerësimit, do të paguante normë interesi 3% mbi shumën, ndërsa pjesa tjetër e interesit do të paguhej nga Ministria e Financave, në zbatim të marrëveshjes nr. {***} prot., datë 20.06.2005, ndërmjet Raiffeisen Bank dhe Ministrisë së Financave, për trajtimin me strehim të funksionarëve të lartë të shtetit, lidhur në zbatim të VKM-së nr. 102, datë 5.3.1999 dhe VKM-së nr. 830, datë 10.12.2004.
3. Nga aktet e çështjes, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, ka depozituar në bankë, për marrjen e kredisë, një kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “{***}” ShPK, lidhur në datën 25.8.2006, me objekt “blerjen e një apartamenti me sipërfaqe 132,5m²”, në adresën: rr. “{***}”, lagjja nr. {***}, k. {***}, Durrës, me çmimin 6.000.000 (gjashtë milionë) lekë.
4. Më datë 25.09.2006, në llogarinë e pagës së subjektit të rivlerësimit në Raiffeisen Bank, është disbursuar kredia në shumën 5.000.000 lekë, me qëllim pagimin e çmimit të apartamentit të blerë nga shoqëria “{***}” ShPK.
5. Subjekti i rivlerësimit, brenda vitit 2006, ka hequr dorë nga blerja e apartamentit në qytetin e Durrësit, në mirëkuptim me shoqërinë shitëse, por pa hartuar akte shkrësore formale dhe, si rrjedhojë, shuma e kredisë prej 5.000.000 lekësh, nuk i është paguar shoqërisë “{***}” ShPK.
6. Më datë 03.11.2006, subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, ka tërhequr nga llogaria në Raiffeisen Bank shumën prej 5.000.000 lekësh, të cilën e ka derdhur në llogari bankare, rrjedhëse, të hapur në ProCredit Bank në emër të saj dhe, pasi ka bërë disa veprime tërheqjeje dhe kreditimi në këtë llogari, më datë 30.04.2007 e ka zeruar atë, duke e nxjerrë gjithë shumën e përfituar nga kredia jashtë sistemit bankar.

7. Nga aktet e çështjes, rezulton se në një komunikim elektronik që subjekti i rivlerësimit ka pasur në datën 24.9.2010 me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave në lidhje me shpjegimet e dhëna për pasurinë apartament banimi, të porositur sipas kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.10.2009, lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK, ka deklaruar: *Në këstin e parë përfshihet kredia e marrë për këtë qëllim në vitin 2006, e cila është konvertuar nga lekë në euro dhe anasjelltas, në varësi të kursit të këmbimit valutor, duke qenë se e disponoja “cash”.*
8. Subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, në deklaratat periodike të viteve 2006, 2007 dhe 2008, ka deklaruar kursime nga paga, **por nuk ka deklaruar posedimin në cash të shumës prej 5.000.000 lekësh**, të përfituar nga kredia bankare e dhënë nga Raiffeisen Bank dhe e tërhequr cash prej saj pas depozitimit në ProCredit Bank.
9. Me anë të kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.10.2009, lidhur me shoqërinë sipërmarrëse “{***}” ShPK, subjekti i rivlerësimit ka porositur ndërtimin e një apartamenti me sipërfaqe 115 m², në rrugën “{***}”. Sipas nenit 2 të kësaj kontrate, vlera e apartamentit është 92.000 euro, nga të cilat 72.000 euro janë likuiduar jashtë zyrës noteriale në të cilën është nënshkruar kontrata, ndërsa shuma prej 20.000 eurosh do të likuidohej me kryerjen e aktit përfundimtar të shitblerjes së pronës. Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.11.2011, administratori i shoqërisë “{***}” ShPK deklaroi se ka marrë nga subjekti i rivlerësimit shumën totale prej 92.000 eurosh, jashtë zyrës noteriale, për blerjen e apartamentit në Tiranë, shumë që rrjedh nga kontrata e porosisë së datës 09.10.2009.
10. Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Më datë 09.10.2009, kam lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK, kontratën e porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., ku kam porositur një apartament banimi me sipërfaqe 115 m², në katin e pestë banimi, seksioni {***}, në pozicionin jugperëndim, e ndodhur si pronë në rrugën “{***}”, Tiranë. Shuma totale e apartamentit është 800 euro/m² e në total shuma e përgjithshme është 92.000 euro. Kam likuiduar këstin e parë prej 72.000 eurosh dhe këstin e dytë prej 20.000 eurosh do e likuioj me kryerjen e aktit të shitblerjes së pronës, sipas ligjit. Në këtë deklaratë, subjekti **nuk e ka treguar burimin e krijimit të shumës për likuidimin e këstit të parë prej 72.000 eurosh**, duke shkelur detyrimet ligjore të përcaktuar nga ligji nr. 9049/2003.*
11. Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se *deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit.*
12. Në deklaratën e pasurisë vetting, si burim të krijimit të apartamentit të banimit në rrugën “{***}” në Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Burim i të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie janë:*
*Më datë 18.09.2006, kam lidhur me Raiffeisen Bank ShA kontratën e kredisë bankare për blerje apartamenti me nr. {***} rep., nr. {***} kol. Shuma totale e kredisë është 5.000.000 (pesë milionë) lekë.*

Të ardhura nga paga të siguruara nga puna ndër vite të përshkruara më poshtë.

[...]

13. Në analizë të fakteve të mësipërme, në vlerësimin tim, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë deklaruar në asnjë prej deklaratave periodike të viteve 2007 e 2008, por aq më tepër as në atë të vitit 2009, posedimin *cash* në banesë të shumës së kredisë prej 5.000.000 lekësh ose përdorimin e saj në lekë apo në euro, e bën të pamundur për institucionet e rivlerësimit gjurmimin e ekzistencës së kësaj shume në vitet përkatëse.
14. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se, nëpërmjet përfshirjes në vitet 2007-2009, të shumës së marrë kredi, prej 5.000.000 lekësh, në transaksione në tregun e lirë të këmbimit valutor dhe se nëpërmjet kurseve të këmbimit, ka gjeneruar të ardhura shtesë, është i paprovuar, pasi nëse do të kishte ndodhur një gjë e tillë, ky fakt, në zbatim të detyrimeve ligjore, duhet të ishte deklaruar në deklaratat periodike të viteve përkatëse, duke identifikuar vlerën e shtuar apo të pakësuar nga përdorimi i vlerës së kredisë në tregun e lirë të këmbimit valutor. Sikurse ka pohuar vetë subjekti i rivlerësimit në Komision, *është vërejtur një luhatje e madhe e kursit të këmbimit në vitet 2007 – 2009 (nga 121 lekë/euro në 137 lekë/euro, sipas Bankës së Shqipërisë)* dhe, si pasojë e këtij fakti, është e logjikshme arritja në konkluzionin që nga përfshirja në tregun e lirë të këmbimit valutor të shumës së marrë kredi, nuk duhet prezumuar se subjekti i rivlerësimit ka fituar të ardhura nga këto transaksione financiare, pasi ekziston edhe mundësia tjetër që subjekti të ketë pësuar humbje të konsiderueshme nga këto transaksione, për shkak të luhatjeve të kursit të këmbimit.
15. Vlerësimi i efektit financiar të këtyre transaksioneve të pretenduara, të cilat nuk janë identifikuar as në drejtim të kohës së kryerjes dhe frekuencës së tyre, as në drejtim të mënyrës së realizimit, është i pamatshëm. Për më tepër, rezultoi që as gjatë hetimit në Komision, si dhe as para Kolegjit, subjekti i deklarimit nuk ka krijuar qartësi nëse këto transaksione i ka kryer personalisht, apo nëpërmjet subjekteve të specializuara dhe të licencuara për këtë qëllim, duke u besuar atyre posedimin e kësaj shume. Subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, gjatë procesit të rivlerësimit, është përpjekur t'i paraqesë transaksionet e këmbimit valutor vetëm në funksion të këmbimit të shumës së kredisë nga lekë në euro, por ky pretendim bie në kontradiksion të hapur me pohimin që ajo ka bërë në vitin 2010 për ILDKPKI-në: *kreditë e marrë në vitin 2006 e kam konvertuar nga lekë në euro dhe anasjelltas, në varësi të kursit të këmbimit valutor, duke qenë se e disponoja "cash"*. Ky pohim është bërë para të vetmit institucion shtetëror të kohës, të ngarkuar nga ligji për kontrollin e vazhdueshëm të pasurive të funksionarëve publikë dhe shumë afër në kohë me periudhën kur pretendohet se janë kryer transaksionet e këmbimit valutor (vitet 2007-2009). Në vlerësimin tim, deklaratimet e subjekteve të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, të cilat vijnë në kontradiksion me deklaratimet periodike vjetore, si dhe me sqarimet e dhëna gjatë procedurave verifikuese të ILDKPKI-së, nuk krijojnë besueshmëri në raport me deklaratimet e mëparshme, pasi ekziston mundësia që të jenë diktuar nga nevoja e rimodelimit të situatave faktike në funksion të procesit të rivlerësimit. Në përmbyllje të kësaj analize, arrij në konkluzionin se është objektivisht e pamundur për të kontrolluar transaksionet e kryera me shumën e kredisë dhe verifikimin e të ardhurave të pretenduara si të krijuara si pasojë e këtyre transaksioneve, me qëllim

arritjen në përfundimin nëse shuma e kredisë dhe të ardhurat e gjeneruara prej saj nga transaksionet e këmbimit valutor, përbëjnë apo jo burim të ligjshëm për pagimin e këstit të parë prej 72.000 eurosh të çmimit të apartamentit.

16. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se, me përdorimin e shumës së marrë kredi me kushte lehtësuese nga shteti, për realizimin e të ardhurave nga këmbimi valutor, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, vlerësoj se, pavarësisht nga fakti se ky shkak ankimi nuk u pranua nga shumica e trupit gjykues si një shkelje etike, dhe në vlerësimin tim nuk arrin në nivelin e një shkak për zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, kjo sjellje e subjektit të rivlerësimit, në abuzim të mbështetjes ekonomike që shteti i ka dhënë për shkak të detyrës, duke përdorur kredinë me kushte lehtësuese për qëllime fitimprurëse, është e papranueshme. Në arritjen e këtij konkluzioni, kam mbajtur parasysh faktin se për këtë kredi, shteti në vitet 2006 – 2009, me paratë e taksapaguesve, i ka paguar bankës për llogari të subjektit, një pjesë të interesit prej 9% në vit, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ka paguar pjesën tjetër prej 3% dhe ndërkohë ka bërë veprimtari këmbimi valutor.
17. Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik për burimin tjetër të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, për blerjen e apartamentit, që janë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit të siguruara nga puna ndër vite, rezulton se në këtë deklaratë, subjekti nuk ka përcaktuar se bëhet fjalë për kursimet e deklaruara në deklaratat periodike vjetore në gjendje *cash* në banesë, në vitet 2006-2009, por është mjaftuar me deklarin e këtij burimi, si të ardhura të përfituara nga punësimi ndër vite. Nga verifikimi i deklarimeve periodike pranë ILDKPKI-së, rezulton se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, në të cilën subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratën e porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.10.2009, lidhur me shoqërinë sipërmarrëse “{***}” ShPK, për blerjen e apartamentit, nuk ka deklaruar burimin e krijimit të shumës së përdorur për likuidimin e këstit të parë prej 72.000 eurosh, duke shkelur detyrimet ligjore të përcaktuar nga ligji nr. 9049/2003. Gjithashtu, referuar së njëjtës deklaratë periodike, nuk rezultoi të ishte deklaruar as pakësimi i kursimeve gjendje *cash* në banesë të akumuluar, sipas deklarimeve periodike deri në atë vit. Subjekti i rivlerësimit rezultoi të ketë pretenduar se si burim për pagimin e këstit të parë të apartamentit, kanë shërbyer kursimet *cash* të deklaruara në deklaratat periodike 2006 – 2009, në shumën totale prej 2.050.000 lekësh, për herë të parë, vetëm në fazën e hetimit administrativ në Komision. Në këto kushte, vlerësoj se deklarinet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, nuk përputhen as me deklaratat periodike vjetore dhe as me deklaratën e pasurisë *vetting* dhe, si rrjedhojë, e gjej të drejtë pretendimin e Komisionerit Publik se, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, kursimet gjendje *cash* në banesë nuk mund të konsiderohen si burim i ligjshëm për pagimin e këstit prej 72.000 eurosh në vitin 2009. Kolegji, në vendimin (JR) nr. 7/2019, paragrafi 39, bazuar në nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ndër të tjera, ka orientuar Komisionin që *të mos prezumojë përdorimin nga subjektet të gjendjeve “cash” si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike [...].*

18. Në përfundim, vlerësoj se për shkak të problematikave të trajtuara më lart lidhur burimet e deklaruarra: *të ardhura nga kredia dhe të ardhura të siguruara nga puna ndër vite*, të përdorura për krijimin e pasurisë “apartament me sip. banimi 115 m²”, vlerësoj se në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, germa “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm lidhur me këtë pasuri. Si rrjedhojë, kam arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së saj dhe, si pasojë, nuk duhej të konfirmohej në detyrë.

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi